



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Sigurinë Kombëtare

PROCESVERBAL

Tiranë, më 13.11.2018, ora 10:30

Drejton mbledhjen:

Ermonela Felaj – kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

1. Seancë dëgjimore për nevojat buxhetore të Drejtorisë së Përgjithshme të Emergjencave Civile për vitin 2019.
2. Seancë dëgjimore për nevojat buxhetore të Drejtorisë së Kufirit dhe Migracionit për vitin 2019.

Marrin pjesë:

Ermonela Felaj, Pjerin Ndreu, Xhemal Qefalia, Luan Duzha, Luan Harusha, Sadi Vorpsi, Vullnet Sinaj, Elona Hoxha, Anduel Xhindi, Klodjana Spahiu dhe Spartak Braho.

Mungojnë:

Andon Frrokaj, Luan Rama, Paulin Sterkaj, Myslym Murrizi, Ervin Salianji, Flamur Noka, Endrit Brahimllari, Xhemal Gjunksi dhe Isuf Çelaj

Të ftuar:

Haki Çako – Drejtor i Përgjithshëm i Emergjencave Civile në Ministrinë e Mbrojtjes

Ismail Shehu – Drejtor i Drejtorisë së Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Akteve Rregullatore

Nuri Laknori – Drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar në Ministrinë e Mbrojtjes

Dukate Dodaj – Specialiste në Drejtorinë e Planifikimit dhe Koordinimit të Emergjencave Civile

Gentian Opre – Drejtor i Drejtorisë së Analizës dhe Programimit Buxhetor në Ministrinë e Financave

Xhoana Agolli – Drejtor i Menaxhimit të Buxhetit në Ministrinë e Financave

Valion Cenaliaj – Përfaqësues i Ministrisë së Financave

Ndue Doci – Përgjegjës Sektori në Drejtorinë e Kufirit dhe Migracionit

Shpetim Ahmetaj – Përfaqësues i Drejtorisë së Kufirit dhe Migracionit

Pëllumb Aliaj – Përfaqësues i Drejtorisë së Kufirit dhe Migracionit

HAPET MBLEDHJA

Ermonela Felaj – Mirëdita!

Hapim mbledhjen e Komisionit për Sigurinë Kombëtare. Sot në rendin e ditës së mbledhjes kemi parashikuar seancë dëgjimore me dy njësi të rëndësishme sipas gjykimit të këtij komisioni, përkatësisht me Drejtorinë e Përgjithshme të Emergjencave Civile dhe me Drejtorinë e Kufirit dhe Migracionit. Ideja është që të dyja seancat dëgjimore të zhvillohen në një mbledhje të vetme.

E para lidhet pikërisht me nevojat buxhetore që ka Drejtoria e Përgjithshme e Emergjencave Civile dhe mënyrën sesi janë reflektuar këto nevoja në buxhetin e vitit 2019. Paraprakisht në këtë komision ne kemi pasur edhe ministren e Mbrojtjes, e cila bëri një prezantim të hollësishëm të buxhetit të mbrojtjes për vitin 2019, i cili duhet thënë se është rritur në raport me buxhetin e vitit 2018 dhe që besojmë se do të mund t'i mbështesë, ashtu siç duhet, emergjencat civile dhe jo vetëm. Sidoqoftë, meqenëse në krye të emergjencave civile tani kemi një drejtues të ri, zotin Haki Çako, të cilin i uroj mirëseardhjen në komisionin, por edhe punë të mbarë, do të donim ta zhvillonim këtë seancë për të dëgjuar nevojat e këtij institucioni dhe për të reflektuar, nëse do të jetë e mundur, të bëhen ndryshime në buxhet, meqenëse nuk është miratuar ende në Kuvendin e Shqipërisë.

Në pjesën e parë të mbledhjes kemi të ftuar zotin Haki Çako, drejtori i Përgjithshëm i Emergjencave Civile në Ministrinë e Mbrojtjes. Faleminderit, zoti Çako! Kemi të ftuar gjithashtu: zotin Ismail Shehu, drejtor i Drejtorisë së Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Akteve Rregullatore, zotin Nuri Laknori, drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar në Ministrinë e Mbrojtjes, Dukate Dodaj, specialiste në Drejtorinë e Planifikimit dhe Koordinimit të Emergjencave Civile, ndërkohë që nga Ministria e Financave kemi zotin Valion Cenaliaj.

Siç e thashë, është një seancë dëgjimore, nuk kemi relator dhe as votim. Ideja është të dëgjojmë nevojat e institucionit tuaj.

Faleminderit!

Haki Çako – Faleminderit, zonja kryetare!

Ashtu sikurse e theksuat edhe ju, para pak ditësh ministrja e Mbrojtjes bëri një relativim të gjithë buxhetit të Ministrisë së Mbrojtjes.

Drejtoria e Përgjithshme e Emergjencave Civile, tashmë si pjesë e institucionit të Ministrisë së Mbrojtjes, mbështetet në programin e qeverisë dhe në vizionin e saj strategjik dhe ka si objektiv kryesor zhvillimin e politikës shqiptare për mbrojtjen civile nga emergjencat dhe fatkeqësitë, duke synuar, midis të tjerave, rritjen e sigurisë së qytetarëve të kërcënuar apo të goditur nga fatkeqësitë ndryshme, zvogëlimin e cenueshmërisë së jetës së njerëzve, pronës, trashëgimisë, kulturës, mjedisit, emergjencave civile dhe ofrimin e mbrojtjes civile për ta.

Një nga drejtimet kryesore të punës së Drejtorisë së Përgjithshme të Emergjencave Civile është edhe sistemi i menaxhimit të mbrojtjes civile nga emergjencat dhe fatkeqësitë, rritja e këtij sistemi në përputhje me kushtet aktuale, duke forcuar kapacitetet administrative teknike dhe financiare dhe duke rritur forcën bashkërenduese ndërinstitucionale.

Prioritetet e punës së Drejtorisë së Përgjithshme të Emergjencave Civile për vitin që vjen konsistojnë në ndjekjen në mënyrë të vazhdueshme të situatës në vend, në monitorimin e territorit, sidomos në disa zona me risk të lartë dhe në objekte infrastrukturore dhe në bashkërendimin në nivel kombëtar dhe qendror për masa parandaluese dhe mbrojtëse, si dhe zhvillimi më tej i veprimeve koordinuese për përballimin e situatave emergjente. Janë ndjekur në mënyrë të vazhdueshme situatat emergjente në shkallë vendi nëpërmjet një koordinimi efikas me strukturat qendrore dhe vendore për përballimin e këtyre situatave.

Dëmtimet e banesave dhe tërmetet për vitin 2018

Në qarkun e Vlorës në gusht 2018; në qarkun e Dibrës dhe në qarkun e Lezhës situatat e zjarreve të vjeshtës së këtij viti. Në nivel të bashkërendimit kombëtar dhe qendror është koordinuar dhe është bashkëpunuar me ministritë e linjës dhe me njësitë e qeverisjes vendore për ndjekjen e situatave për planifikimin dhe zbatimin e masave parandaluese të mbrojtëse për menaxhimin e situatave të ndryshme për përditësimin e të dhënave dhe përballimin e emergjencave civile, duke komunikuar drejtpërdrejt me strukturat e përhershme dhe të përkohshme në shërbimet e emergjencave civile në nivel qendror dhe vendor, në qarqe e në bashki. Është punuar për trajnimin dhe për profesionalizimin për të zgjidhur në një kohë sa më të shpejtë të gjitha problematikat që lidhen me dëmtimet infrastrukturës publike në gjithë territorin e vendit dhe planifikimin e financimit të të gjitha ndërhyrjeve parandaluese dhe rehabilituese të asaj infrastrukture që ka paraqitur probleme.

Është ushtruar kontroll mbi mënyrën e përdorimit të burimeve e materialeve financiare të propozuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Emergjencave Civile dhe vënien në dispozicion nga

buxheti i shtetit ose nga programi i emergjencave civile për organet qendrore dhe vendore. Për situatat e pritshme vjeshtë-dimër-pranverë nga Drejtoria e Përgjithshme e Emergjencave Civile u është kërkuar institucioneve të prefektit dhe institucioneve qendrore zbatimi i detyrave nga ana e tyre dh dërgimi pranë Ministrisë së Mbrojtjes i një raporti të hollësishëm për gjendjen dhe për përballimin e emergjencave civile. Mbi bazën e informacioneve, Drejtoria e Përgjithshme e Emergjencave Civile bën një vlerësim të pikave të kontaktit të strukturave të ndryshme që angazhohen në rast emergjencash, të gjendjeve të mallrave të disponueshme, si dhe të dhënave për kapacitetet njerëzore, mjetet dhe pajisjet, të cilat mund të angazhohen në këto institucione në rast të emergjencave të mundshme sezonale.

Funksionimi në një nivel të lartë i komisioneve të planifikimit dhe të përballimit të emergjencave civile në nivel qarku dhe bashkie është një domosdoshmëri, e cila është ndjekur hap pas hapi; sigurimi dhe gatishmëria e ambienteve të planifikuara për strehimin e përkohshëm të popullsisë së evakuar në rastet e fatkeqësive të ndryshme, përditësimi i të gjitha dhënave për resurset që disponojnë qarqet, bazat materiale dhe teknike nën administrimin shtetëror dhe privat, si dhe përcaktimi i mënyrave të përdorimit të tyre në rast të situatave të emergjente. Është punuar për rritjen e bashkëpunimit dhe koordinimit me strukturat e policisë, në mënyrë të veçantë me strukturat e tjera të MZSH-së, të agjencive të ndryshme, veçanërisht për sigurimin e rasteve të situatave emergjente, për gjendjen e digave, rezervuarve, ujëmbledhësve dhe mekanizmave të shkarkimit, për gjendjen e shërbimeve publike etj. Të gjitha masat janë marrë për lehtësimin e procedurave doganore në rastet e ndihmave të jashtme, si dhe për bashkëpunimin me bashkitë për kërkesa të tjera që lidhen me çështje të emergjencave civile. Po kështu, është bashkëpunuar me Autoritetin Rrugor, për shkak se sezoni dimëror në vendin tonë rezulton të jetë i vështirë për problematikat e rrugëve.

Drejtoria e Përgjithshme e Emergjencave ka pasur një bashkëpunim me këtë autoritet. Ky bashkëpunim konsiston në drejtim të shkëmbimit të informacionit lidhur me kapacitetet njerëzore, me kapacitete e mjeteve të kontratave të lidhura midis Autoritetit Rrugor Shqiptar dhe firmave për mirëmbajtjen e rrugëve sipas qarqeve etj. Bazuar në informacionet e dërguar nga qarqet, sidomos për rrugët, Drejtoria e Përgjithshme e Emergjencave ka bashkëpunuar ngushtë me këtë autoritet për lehtësimin e të gjitha vështirësive të krijuara. Gjithashtu, disa nga partnerët kryesorë të bashkëpunimit të emergjencave civile janë edhe Instituti i Gjeoshkencës, i Ujit, Mjedisit, Shërbimi Gjeologjik Shqiptar etj.

Arritjet e Drejtorisë së Përgjithshme të Emergjencave Civile në drejtim të masave të strukturuar: akordimi i plotë dhe në një kohë të shkurtër i vlerës financiare prej 85 milionë lekësh për eliminimin e rrëshqitjes së kodrës së Shtufit në lagjen “18 shtatori” në Gjirokastrë, do të lehtësojë problematikat e krijuara dhe do të ketë një ndikim të prekshëm në përmirësimin e kushteve të jetës së familjeve të tyre dhe është në përputhje të plotë me një nga prioritetet e programit të qeverisë, që është përmirësimi i kushteve; ndërhyrja për rehabilitimin e argjinaturës së Vjosës në territorin e Bashkisë së Fierit, sipas projektit të hartuar nga Bashkia e Fierit dhe ajo e Vlorës në bashkëpunim me disa institucione, sikurse ka qenë Bordi i Kullimit, Ministria e Mbrojtjes, Bashkia e Fierit dhe ajo e Vlorës, nën përkujdesjen e veçantë të Kryeministrit, si dhe segmenti rural “Muhër-Selishtë i rehabilituar nga batalioni i xhenios me një gjatësi 16 kilometra, ku, përveç mundësive të lëvizjes së mjeteve të Forcave të Armatosura, është lehtësuar ndjeshëm edhe lëvizja e banorëve.

Në këtë kuadër, Drejtoria e Përgjithshme e Emergjencave Civile ka punuar edhe për përmirësimin e legjislacionit bazë të emergjencave, për marrëveshjet, për programet dhe projektet. Projektligji për mbrojtjen civile, i cili ka si qëllim zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile për të garantuar mbrojtjen e jetës së njerëzve, të pronës, të trashëgimisë kulturore të mjedisit nëpërmjet forcimit të sistemit të mbrojtjes civile, tashmë në proces konsultimi të plotë dhe është hedhur në sistem.

Marrëveshjet për bashkëpunimin dhe ndihmën e ndërsjellë në rast fatkeqësish me vendet e rajonit, si dhe me vendet e tjera të BE-së

Disa nga programet kryesore që mbështesin mbrojtjen civile dhe emergjencat në Shqipëri, sikurse është programi i përmirësimit të sistemit të paralajmërimit dhe parandalimit të hershëm të përmbytjeve, PRONEWS nëpërmjet të cilit janë rishkuar dhe janë përditësuar planet e përballimit të emergjencave civile në të gjitha qarqet, të cilat do të shërbejnë edhe si model për hartimin e planeve të bashkive. Janë zhvilluar disa fushata kombëtare të ndërgjegjësimit publik, bazuar në praktikatat e mira kombëtare të mbrojtjes civile dhe ato të BE-së gjatë muajve maj-korrik dhe shtator në Tiranë dhe në muajin tetor në qytetet e Shkodrës, Vlorës.

Është në proces zhvillimi i hartave të rrezikut të përmbytjeve në përputhje me direktivat BE-së për përmbytjet. Gjithashtu, emergjencat civile kanë organizuar dhe janë në aktivitet të ngushtë lidhur me stërvitjet e përbashkëta përveç projekteve që po implementohen në vendin tonë. Pjesë e rëndësishme e bashkëpunimit janë edhe këto stërvitje në kuadër të iniciativës së USA-5

Adriatic Charter. Në vendin tonë do të zhvillohet stërvitja e përbashkëta për emergjencat civile e koduar “*Join direction 19*”, e cila do të realizohet në katër faza për t’u përmbyllur përfundimisht në tetor 2019 me pjesëmarrjen e gardës së Nju Xhersit dhe të disa vendeve të rajonit, sikurse është Maqedonia, Mali i Zi, Kroacia, Bosnje Hercegovina, Sllovenia dhe Kosova. Më duhet të theksoj se ky projektbuxhet është i një viti buxhetor, por jo i emergjencave civile specifike, të cilat karakterizojnë domosdoshmërinë e menaxhimit dhe të rialokimit të fondeve nga qeveria shqiptare lidhur me emergjencat e paparashikuara, sikurse mund të jenë rastet e përmbytjeve, të tërmeteve apo edhe të fenomeneve të tjera natyrore. Në këto kushte, më duhet të theksoj se buxheti për vitin 2019 i parashikuar është pak a shumë në të njëjtat limite me ato të vitit 2017-2018, i parashikuar në zëra specifike dhe në artikujt 602, 604 dhe 605.

Nëse do të duhet ta specifikojmë buxhetin me zëra, mund të theksoj se mbartet një detyrim i cili lidhet me dëmshpërblimin e banorëve në lidhje me përmbytjet dhe me tërmetet e viteve të kaluara, duke përfshirë procedurat e papërmbyllura të vitit 2018 për tërmetet e ndodhura në Vlorë dhe në qarqet Dibër e Lezhë në vitin 2018.

Më duhet të theksoj se e gjithë vlera e buxhetit të planifikuar për vitin 2019 nga emergjencat civile brenda programit të Ministrisë së Mbrotjtjes arrin në rreth 700 milionë lekë dhe përfshin detyrimet, por mbi të gjitha, janë një sërë artikujsh të cilët lidhen me 602 me mallra shërbime të tjera, që përdoren për shpenzime, për transport, për pjesë këmbimi, siguracione, por brenda saj janë përfshirë edhe detyrimet që lidhen me dëmshpërblimin e familjareve të banesave, të cilat janë dëmtuar nga fatkeqësitë e ndryshme. Njëkohësisht, mund të them se Drejtoria e Përgjithshme e Emergjencave Civile ka në planifikimin e vet edhe një sërë detyrimesh të tjera, të cilat pas plotësimit të dokumentacionit që përputhet me udhëzimin përkatës dhe me vendimin e Këshillit të Ministrave do t’i mbartet hap pas hapi sipas vlerës së shtuar, e cila vjen nga komisionet e konstatimit dhe të vlerësimit në bazë qarqesh. Në këto kushte, dua të them se vlera reale e parashikuar nuk është e përcaktuar qartë, pasi detyrimi është thjesht i mbartur, duke mos parashikuar situatën që vjen përpos saj.

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Çako!

Ju e thatë edhe vetë besoj dhe kjo në fakt është fjala më me vend që unë gjeta në prezantimin tuaj, që emergjencat vetëm nga fakti që janë të papritura natyrisht nuk mund të llogariten deri në detaje. Sidoqoftë, vlen për t’u përgëzuar fakti që në të gjitha rastet, kur kemi pasur emergjenca civile në vend, është bërë një punë shumë e mirë për përballimin e të gjitha

pasojave të shkaktuara, të cilat fatmirësisht kanë qenë vetëm në materiale dhe jo në njerëz. Nga vetë natyra që kanë emergjencat kuptohet që është e nevojshme vazhdimisht që qeveria të ndërhyjë dhe t'i fuqizojë emergjencat. Unë gjykoj se fuqizimi i emergjencave nuk është thjesht dhe vetëm në financë, por është edhe në legjislacionin e ri që duhet të shoqërojë tashmë emergjencat civile. Natyrisht, ne jemi shumë të gatshëm si deputetë të këtij komisioni të japim kontributin tonë edhe në ligjin e ri për mbrojtjen civile.

Megjithatë, do t'ua kaloj fjalën kolegëve dhe do të çel diskutimin në lidhje me këtë çështje, me synimin, nëse mundemi me nxitjen e këtij komisioni, të bëjmë të mundur ndryshimin e zërave ose rialokimin e zërave, me qëllim që nevojat e emergjencave civile të mbështeten më mirë nga buxheti i vitit 2019, i cili, në fakt, pavarësisht masës së rritjes, është një buxheti që është më i madh, në krahasim me vitin 2018 dhe rezulton një rritje në kufijtë 2%, sipas të dhënave që më janë vënë para nga stafi i komisionit.

Zoti Sinaj, keni fjalën.

Vullnet Sinaj – Ju falënderoj për fjalën tuaj dhe për përshkrimin e situatës dhe të masave që keni marrë! Në fjalën tuaj dëgjova që folët për dëmet e tërmetit në vitin 2018 në Vlorë dhe unë jam deputet i asaj zone. Bëhet fjalë për fshatrat Bashaj, Matogji. Dua të di nëse ka ardhur ndonjë informacion te ju për vlerat e dëmit të këtij tërmeti. Nga informacioni që kam unë, Bashkia e Selenicës nuk e ka mbledhur ende këshillin bashkiak për të vlerësuar përfundimisht dëmet dhe për të marrë një vendim se çfarë do të bëjë me marrjen e masave për t'u ardhur në ndihmë këtyre banorëve, sepse janë banorë të zonave malore. Është një situatë që unë e kam shprehur edhe herë tjetër, për të cilën duhen marrë masat të paktën në buxhetin tuaj, sepse, sido që të jetë, ajo bashki do ta mbledhë një ditë atë këshill bashkiak, ose do të ndodhë diçka tjetër që bashkia e re do të marrë vendimin e parë për përmirësimin e situatës atje, sepse ka familje që jetojnë në çadra. Ju e dini shumë mirë, sepse ka qenë drejtorja juaj që ka çuar çadra për rreth 5 familje apo më tepër familje atje për të kaluar kohën, kështu që nuk mund ta përballojnë dimrin. Do t'ju kërkoj që në këtë buxhet për vitin 2019 të planifikoni për riparimin e këtyre dëmeve të këtyre shtëpive dhe sistemimin e atyre familjeve. Them shumë bukur që të drejtat apo detyrat drejtorisë suaj janë marrja e masave për mbrojtjen nga këto fenomene dhe sigurimin e jetës së banorëve. Në këtë rast është një ngjarje jo vetëm e jashtëzakonshme për tërmetin që ka ndodhur, por edhe për papërgjegjshmërinë e asaj bashkie. Nuk mund ta lëmë atë bashki të jetë e papërgjegjshme. Kështu, kërkoj nga ju të merrni masa, nëse nuk ju ka ardhur asgjë.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Po, zoti Çako!

Haki Çako – Në lidhje me dokumentacionin e tërmetit të ndodhur në Vlorë, në mënyrë specifike për zonën e Selenicës dhe të fshatrave përreth mund të them se nuk ka arritur ende në Drejtorinë e Përgjithshme të Emergjencave i gjithë dokumentacioni konform kritereve të përcaktuara qartë në vendimin e Këshillit të Ministrave, pasi Drejtoria e Përgjithshme e Emergjencave Civile bën një vlerësim në përputhje të plotë me të gjitha detyrimet që u përkasin komisioneve të vlerësimit dhe komisioneve të konstatimit. Është një domosdoshmëri plotësimi i dokumentacionit dhe vlerësimi i dëmit konkret në vend. Në këto kushte, ne administrojmë të gjithë dokumentacionin. Ndaj thashë që në përlllogaritjen e detyrimit buxhetor ne kemi marrë në konsideratë ato vlera, të cilat janë me dokumentacion të plotë, ndryshe do të duhet të themi se kjo do të mbartet në një vlerë buxhetore për të ardhmen, por kurrësi nuk do të mbetet pa u trajtuar detyrimi që buron për Drejtorinë e Përgjithshme të Emergjencave Civile përpos trajtimit nga bashkia ose qeverisja vendore për ato vlera që përcakton ligji. Gjithsesi mund të them që ne kemi në vëmendje të përhershme dhe insistojmë, dërgojmë edhe grupe inspektimi për t'i ndihmuar dhe për t'i konsultuar lidhur me dokumentacionin që ata duhet të plotësojnë rast pas rasti lidhur me dëmet që janë shkaktuar nga fatkeqësitë natyrore, ashtu sikurse është edhe rasti në fjalë.

Faleminderit!

Vullnet Sinaj – Unë kam një informacion nga këshilli i qarkut, i cili ka bërë vlerësim të saktë të dëmeve dhe ia ka kaluar Bashkisë së Selenicës. Dua t'ju them se nëpërmjet prefektit i kërkojmë bashkisë së Selenicës të marrë masa urgjente për t'i kaluar këto. Kështu që në pozicionin tuaj si drejtor i Emergjencave Civile duhet të bashkëpunoni më shumë me prefekturën, në mënyrë që ta detyrojnë atë bashki për ta mbaruar këtë vlerësim, sepse ne nuk e dimë se çfarë mund të sjellë dimri dhe ato janë fshatra rrëzë maleve, ku bie dëborë dhe temperaturat janë të ulëta. Kështu që ju kërkoj ta shikoni me më përgjegjshmëri këtë problem të zonës sime.

Faleminderit!

Ermonela Felaj - Faleminderit, zoti Sinaj!

Fjala për zotin Xhindi.

Anduel Xhindi – Faleminderit, kryetare!

Në fakt, unë kam një pyetje konkrete dhe nuk e di nëse më ndihmoni me një shifër. Sa është numri i familjeve të dëmtuara nga përmbytjet, tërmetet dhe shkarjet e tokës në qarkun e Fierit dhe sa për qind prej tyre janë dëmshpërblyer?

Ermonela Felaj - Faleminderit, zoti Xhindi!

Zoti Çako, fjala për ju.

Haki Çako – Ashtu sikurse e thashë, dokumentacion të plotë ka për të gjithë qarqe, ka edhe për qarkun e Fierit. Në dijeninë time, një pjesë e të dëmtuarve në qarkun e Fierit është trajtuar, ndërsa pjesa tjetër është në proces, pa përcaktuar qartë numrin midis të trajtuarve dhe atyre që janë në proces.

Ne, nisur edhe nga fondi që kemi në dispozicion, jemi duke trajtuar dëmshpërblimin për përmbytjet. Shifra është një detyrim rreth 69 milionë lekë për përmbytjet dhe lëkundjet e tërmetit në Zharrëz, ku edhe këtu janë trajtuar një pjesë e tyre, por mbetet ende për t'u vlerësuar.

Person – Lidhur me shkarjet e tokës, në zonën time ka ende familje, që nga viti 2008, që janë dëmtuar dhe nuk kanë marrë dëmshpërblimin.

Haki Çako – Çështja e shkarjes së tokës në Zharrëz është trajtuar me një vendim të veçantë dhe, me sa di unë, janë shumë pak familje që janë në proces dëmshpërblimi.

Ermonela Felaj – Fjala për zotin Vorpsi, pastaj zoti Harusha.

Sadi Vorpsi –Faleminderit, kryetare!

Në radhë të parë dua t'ju falënderoj për paraqitjen e raportit. Në paraqitjen e buxhetit që ministria bëri para disa ditësh u raportua borxhi i trashëguar, që ishte 700 milionë. Aty u tha se gjatë këtij viti ka pasur një ulje borxhi një herë me 46 milionë lekë rinj dhe një tjetër me rreth 156 milionë. Domethënë që borxhi i trashëguar është në një vlerë prej 540 milionë lekësh të rinj dhe, ashtu si kolegët, edhe ne jemi të interesuar të dimë se sa është parashikuar për vitin 2019 ulja e këtij borxhi?

Haki Çako – Në fakt, vlera është e konsiderueshme dhe ne jemi koshientë që një buxhet vjetor i parashikuar nuk mund të mbulojë 340 milionë lekë, sepse do të duhet t'u akordoheshin vetëm emergjencave civile.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Është parashikuar rreth 330 milionë lekë, vlerë e cila do të kompensojë të gjitha dëmshpërblimet, që janë në përputhje të plotë me ligjin dhe vendimin e Këshillit të Ministrave. Ka mbartje të konsiderueshme, të cilat vijnë edhe për shkak të mungesës së përpilimit të

dokumentacionit ndër vite dhe mbeten për t'u shqyrtuar në të tjera instanca. Këto janë detyrime që duhet të ishin bërë nga pushteti lokal, por edhe ndryshimet që kanë pësuar kanë sjellë problematikën e vet.

Ermonela Felaj – Faleminderit për sqarimin!

Fjala për zotin Harusha.

Luan Harusha – Faleminderit, zonja kryetare!

Pyetja ime është nëse në buxhetin e vitit 2019 janë parashikuar dëmshpërblimet për familjet e përmytura gjatë këtij viti. A keni ndonjë projekt nga drejtorja juaj sesi mund të zgjidhet ky problem, sepse këto fatkeqësi godasin vit pas viti këto zona?

Faleminderit!

Haki Cako – Sigurisht edhe Shkodra, ashtu si të gjitha bashkitë dhe qeverisjet e tjera vendore janë pjesë e integruar e menaxhimit të emergjencave civile dhe një pjesë e konsiderueshme e dëmshpërblimeve realizohen ose trajtohen nga bashkitë dhe, në një limit të caktuar mbi këtë, nëse kapacitetet financiare kalojnë në bazë të ligjit, atëherë detyrimet i marrin emergjencat civile. Në këtë kaudër, ashtu sikurse edhe për zonat e tjera, të cilat kanë qenë të dëmtuara nga përmytjet apo fatkeqësitë natyrore, edhe Shkodra është parashikuar dhe është pjesë e trajtimit financiar të limitit të përlllogaritur, të cilin ne kemi në dispozicion.

Gjithsesi, unë dua të them se Shkodra është një nga vendet me risk më të lartë dhe, në këto kushte, është e domosdoshme që edhe parashikimi i buxhetit, jo vetëm i Emergjencave Civile dhe Ministrisë së Mbrojtjes, por edhe i bashkive respektive, të cilat administrojnë juridiksionin e zonave të përmytura, të kenë në konsideratë vlerat më të shtuara të dëmshpërblimeve.

Në lidhje me masat që do të merren për parandalimin e përmytjeve, ne jemi në një bashkëpunim të ngushtë me partnerët tanë kryesorë, sidomos me një nga projektet më ambicioze të Bashkimit Europian, i cili është projekti PRONEWS. Në Shkodër është avancuar shumë lidhur me saktësimin e hartave të rrezikut të përmytjeve, ashtu sikurse janë një sërë institucionesh të tjera, të cilat janë në kontakt dhe në bashkëpunim ndërinstitutional me ne, që është Autoriteti i Menaxhimit të Ujërave, ose Ministria e Bujqësisë, investime të cilat janë të domosdoshme të shtrihen në të gjitha institucionet dhe jo vetëm tek Emergjencat Civile.

E thashë në fillim që Drejtorja e Përgjithshme e Emergjencave Civile organizon, menaxhon dhe koordinon politikat e përgjithshme të parandalimit dhe paralajmërimit të hershëm lidhur me informacionin që buron për çështjet e përmytjeve apo fatkeqësive të tjera natyrore, ndaj

fondi dhe kapacitetet e emergjencave civile nuk i mbulojnë apo dominojnë mbi fondet e tjera. Pushteti vendor dhe të gjitha institucionet e tjera, të cilat janë përgjegjëse për këtë, duhet të angazhohen më shumë. Faktorët dhe aktorët, që ndikojnë në përmbytje janë të shumtë dhe ka një analizë të veçantë që është trajtuar herë pas here nga ne lidhur me përmbytjet në Shkodër, të cilat kanë të bëjnë me infrastrukturën, me dëmtimet e bazës së lumit, me ndërtimet pa leje dhe një sërë faktorësh të tjerë, të cilët janë në konsideratë dhe duhet të ndiqen hap pas hapi në të gjitha institucionet.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Po, zoti Harusha.

Luan Harusha – Kam një pyetje. A janë përlogaritur dëmet nga përmbytjet e vitit të shkuar?

Haki Çako – Janë përlogaritur të gjitha dëmet e vitit 2017, por nuk kanë mbaruar procedurat për dëmet e muajit shkurt të vitit 2018.

Ermonela Felaj –Fjala për zonjën Gjebrea, pastaj për zotin Ndreu.

Elona Gjebrea – Faleminderit, zoti drejtor, për paraqitjen e plotë!

Më fakt, nëse shohim tabelën e ardhur nga Ministria e Mbrojtjes, zëri i Emergjencës Civile ka një rritje prej 1,8% krahasuar me vitin e kaluar dhe, me aq sa pashë, pas forcave të luftimit dhe mbështetjen për luftimin, kjo është rritja më e madhe të zërat e buxhetit brenda Ministrisë së Mbrojtjes.

Unë kam dy pyetje.

Pyetja e parë ka të bëjë me atë se cili është ai komponent që ju doni t'ia paraqisni komisionit për mbështetje në lidhje me një rritje të buxhetit, e cila, edhe pas diskutimeve që ju keni bërë, nuk është arritur.

Së dyti, edhe pse po shqyrtojmë buxhetin e shtetit, a keni ju mbështetje nga donacione të huaja nëpërmjet projekteve, të cilat, në një farë mënyre ndikojnë në këtë buxhet dhe për këtë arsye mund të jetë paraqitur një buxhet pak më i ulët?

Faleminderit!

Haki Çako – Faleminderit!

Së pari, komponenti bazë ku ne mbështetemi ose operon Drejtoria e Përgjithshme e Emergjencave Civile është dëmshpërblimi, por edhe investime që lidhen me parapërgatitjen ose parandalimin e dëmtimeve të ndryshme. Në këtë kuadër, zëri më i domosdoshëm në aspektin

buxhetor është pikërisht ai i investimeve. Në këtë drejtim, ne e kemi marrë në konsideratë, ashtu siç kemi marrë në konsideratë edhe kërkesën për të rritur trajtimin e dëmshpërblimeve, sepse, siç e thashë, është një vlerë e konsiderueshme e mbartur detyrimesh ndaj qytetarëve, e cila do të duhet të realizohet hap pas hapi në shlyerjen e këtyre detyrimeve, duke mos bërë diferenca midis zonave, individëve apo edhe lloji të dëmit që është shkaktuar.

Lidhur me bashkëpunimin me partnerët ndërkombëtarë, është një orientim i qeverisë shqiptare për një reformë në tërësi të emergjencave civile, e konsideruar ndryshe si një reformë e mbrojtjes civile, duke filluar nga aspekti legjislativ, organizativ dhe administrativ, e cila vazhdon të mbështesë nevojën për një bashkëpunim me të gjithë faktorët ndërkombëtarë. Duke qenë se ka projekte të konsiderueshme të vendeve të BE-së, të rajonit, por edhe të një sërë organizmash të tjerë ndërkombëtarë, të cilët trajtojnë mbrojtjen civile dhe emergjencat civile, ku ne aktualisht jemi në implemtimin e disa prej këtyre projekteve, siç është PRONEWS, projekti i Bashkimit European triateral me Italinë dhe me Malin e zi, për menaxhimin e përmbytjeve, por edhe për zjarret dhe ndotjen detare, ashtu ka edhe një sërë organizmash të tjerë, në të cilat ne aderojmë dhe marrim prej tyre jo vetëm donacione ,që lidhen me përvojën, por edhe në aspektin financiar, të cilat janë përlllogaritur edhe te vlerat specifike që ne i detyrohemi në bazë të përqindjes, për TVSH-në apo elementet e tjera.

Ermonela Felaj – Faleminderit!

Fjala për zotin Ndreu.

Pjerin Ndreu – Faleminderit !

E dëgjova me shumë interes zotin drejtor dhe më vjen mirë që jeni shumë i qartë në përgjigje, por ajo që doja të evedentoja unë lidhet me sistemin parandalues. Evidentimi i vendeve të riskut, unë e di se ju e bëni me shumë kompetencë dhe keni edhe kapacitetet për ta bërë, por pyetja ime është se sa institucione të tjera, para se të ndodhë, janë bashkëpunuese në ato klauzola që ju jepni për riskun, duke futur pushtetin lokal dhe institucionet e tjera, sepse ne e kemi parë që kur ka ndodhur ka pasur mobilizim total, por problemi është para se të ndodhë.

Çfarë masash mendohet të merren për ndërtimet pa leje, zënien e kolektorëve dhe bllokimin e kanaleve, të cilat janë risqe? Sepse, nëse ne shembim një shtëpi për të bërë një rrugë, detyrimisht që do ta shembim që të mos përmbytet e gjithë lagjja. A ka ndonjë ide sesi mund të zgjidhen këto problematika, sepse këto probleme vijnë edhe për shkak të urbanizimit kuturu që është bërë në Shqipëri? Për shembull në Lezhë janë tre lumenj që përplasen dhe më thuhet nga

specialistët që për 250 milionë të vjetër zgjidhet mospërmbytja e një lagjeje. A bashkëpunon pushteti lokal me ju për problemet parandaluese dhe a akordohen fondet? Është e vërtetë që ju jeni drejtori emergjence, por duhet t'i nxisni edhe ata që të bëjnë projekte dhe t'i paraqesin, ose t'i financojnë vetë, ose në qeveri, ose me donatorë, por të gjejnë zgjidhje për disa problematika që mund të zgjidhen. Besoj se ju si institucion duhet të jeni avangardë, në një farë presioni pozitiv, por që në buxhetin e shtetit të planifikohen ndërhyrje decizive për eliminimin e disa pikave të rrezikshme.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Ndreu!

Po, zoti Çako

Haki Çako – Faleminderit, zoti Ndreu!

Për të qenë i sigurtë, isha shumë i interesuar për pyetjen tuaj dhe më lejoni t'ju shpjegoj se ka një koncept, që është shumë i rëndësishëm dhe është i domosdoshëm për t'u konceptuar dhe për t'u kuptuar nga të gjitha institucionet, por edhe nga të gjithë qytetarët, të cilët marrin pasojën e fatkeqësive natyrore në mënyrë të veçantë.

Së pari, prej disa kohësh koncepti ndërkombëtar i vlerësimit të fatkeqësive natyrore ka ndryshuar dhe në këtë kuadër, duke qenë se projekti Sendai për zvogëlimin e riskut të fatkeqësive, i miratuar në vitin 2015 nga Organizata e Kombeve të Bashkuara në Sendai të Japonisë, e ka vënë theksin pikërisht në vlerësimin e riskut në raport me menaxhimin e ndodhjes së fatkeqësisë, që do të thotë të merren masat profilaktike, parandalimit, në raport me koston reale që sjellë një fatkeqësi pas ndodhjes. Unë ju falënderoj për konstatimin e bërë, sepse shumë institucione, bashki, aktorë dhe faktorë nuk e konceptojnë këtë dhe presin ose fillojnë lëvizjen dhe kryerjen e masave pikërisht pas ndodhjes së fenomenit, por është e domosdoshme që të gjitha bashkitë dhe njësitë e pushtetit vendor ta kenë në konsideratë këtë dhe të mos nënvlerësojnë detyrimin aktual, në bazë të ligjit të vitit 2001, por edhe detyrimeve të tjera. Ligji thotë që deri në 3% të buxhetit të një njësie vendore duhet t'u akordohet emergjencave civile, ndërkohë që ajo është totalisht e pamjaftueshme, sepse ata shpeshherë i harrojnë dhe kujtohen në momentin e ndodhjes. Ne në draftligjin që kemi hartuar kemi marrë pikërisht në konsideratë këto arsye, ndaj kemi specifikuar dhe kemi vendosur sanksione, qoftë për të përcaktuar saktë përqindjen buxhetore, dyshemenë buxhetore, që duhet të akordojnë njësitë e pushtetit vendor për çështjeje e emergjencave, por, mbi të gjitha, janë detajuar dhe janë marrë në konsideratë një sërë elementësh, të cilët do t'i detyrojnë jo vetëm njësitë e

pushtetit vendor, por edhe institucionet e tjera të kenë organizmat dhe strukturat e veta për çështjen e paralajmërimit dhe parandalimit të hershëm të emergjencave civile ose të fenomeneve dhe ngjarjeve të ndryshme.

Ne sigurisht që nuk mbahemi si vendi që reagon përpara se të ndodhë, por më duhet të them se Shqipëria është realisht ndër vendet me risk të lartë të lidhura me fatkeqësitë natyrore, qoftë të përmbytjeve, që dihet se nga cilët faktorë vijnë, por edhe për shkak të tërmeteve, si zonë me risk të lartë sizmologjik.

Faleminderit!

Ermonela Felaj –Faleminderit, zoti Çako!

Zonja Spahiu, ka një ndërhyrje.

Klodiana Spahiu – Përshëndetje!

Zoti Çako, nisur nga eksperiencia juaj e verës së këtij viti, si mendoni se është menaxhimi i zjarreve në Shqipëri? Nisur edhe nga ajo që ndodh në rajon nga rritjet e temperaturës, mendoj se ju tashmë e keni krijuar një eksperiencë. Shpeshherë ne shohim kronika, ku diskutohet se janë zjarre të vëna qëllimisht, por pasojat janë goxha të rënda për ambientin. A mendoni se e kemi nën kontroll për vitin e ardhshëm situatën e zjarreve në Shqipëri?

Ermonela Felaj – Urdhëroni, zoti Çako!

Haki Çako – Faleminderit!

Në lidhje me zjarret, ne kemi bërë një analizë të detajuar. Fatmirësisht, gjatë verës, për shkak të masave të marra, por edhe të koordinimit, por, mbi të gjitha, edhe për shkak të kushteve klimaterike, deri diku ishim të favorizuar. Ndërkohë, nuk ndodhi e njëjta gjë në vjeshtën e këtij viti, ku kemi pasur një numër të konsiderueshëm zjarresh, të cilat kanë sjellë dëme dhe pasoja të mëdha në disa zona të caktuara.

Në analizën tonë mbi 85% e rasteve të zjarreve, janë zjarre të vendosura me qëllim nga autorë të ndryshëm, të cilët synojnë hapjen e tokave për qëllime të caktuara, për ndërtime, për bujqësi, në përgjithësi për kullota në zonat malore, ku shpresojnë dhe pretendojnë se djegia bën një riaftësim të barit apo të kullotës, ndërkohë që nuk është aspak e vërtetë. Kjo deri diku lidhet edhe me papërgjegjshmërinë e banorëve, por edhe të personave, të cilët kanë në mbikëqyrje këto zona, qoftë menaxhimin e pyjeve, qoftë menaxhimin e kullotave ose të papërgjegjshmërisë së personave, të cilët në një moment të caktuar bëhen shkak për ndezjen e zjarrit dhe më pas dalja nga kontrolli sjell pasoja të jashtëzakonshme.

Për problemin e zjarreve, sigurisht merren masa paraprake dhe janë një sërë sensibilizimesh dhe masash të planifikuara nga njësitë e pushtetit vendor, por edhe nga prefekturat dhe nga Drejtoria e Përgjithshme e Emergjencave Civile. Ka sanksione ndaj personave, të cilët vendosin zjarre të qëllimshme që sjellin pasoja. Sigurisht, reagimi duhet të jetë më i madh jo vetëm nga agjencitë ligjzbatuese, por edhe nga vetë komuniteti, pasi shpeshherë indiferenca sjell edhe këto pasoja. Gjithsesi, është një fenomen shumë i dëmshëm për shoqërinë, por shpeshherë koshienca është e ulët lidhur me këtë çështje.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit!

Urdhëroni, zoti Duzha!

Luan Duzha - Faleminderit, zonja kryetare!

Në vijim të pyetjes së kolegut Ndreu, kam edhe unë një pyetje, a keni ju një hartë të pikave të rrezikut për çdo bashki, në mënyrë të tillë që edhe bashkia t'i ketë pikat e rrezikut? Pyetjen e kam për rreziqet që vijnë nga përrrenjtë, pasi në dijeninë time investimet e fundit bërë për pritrat e përrrenjve ka shumë vite që janë bërë dhe ato janë të dëmtuara ose të shkatërruara plotësisht. Konkretisht, në zonën time, në komunën Selitë, është një përrua shumë i rrezikshëm dhe prita e fundit që i ka mbetur është gati duke u shembur. Nëse ndodh kjo, do të marrë përpara shumë shtëpi.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit!

Urdhëroni, zoti Çako!

Haki Çako – Sigurisht, ka një hartë, e cila lidhet me fenomenet e ndodhura, aty janë përcaktuar zonat ku ka pasur pasoja. Janë evidentuar dëmet që i janë shkaktuar banorëve të ndryshëm në zona të caktuara. Kjo është një hartë risku, e cila administrohet nga bashkitë dhe nga prefekturat, por edhe nga ne. Sigurisht, në vazhdim kërkohet edhe ndërhyrja e institucioneve të tjera, sikurse është Ministria e Bujqësisë ose Autoriteti i Menaxhimit të Ujërave dhe Burimeve Ujore. Ne jemi në kontakt të vazhdueshëm me të gjitha këto institucione, pikërisht për ato zona të cilat, për shkak të prurjeve të vazhdueshme, mund të ketë pasoja të rënda, por jemi në kontakt edhe me IGJEUM-in, i cili bën parashikimin e motit, të prurjeve e të pasojave të tyre, nëse kanë intensitet të theksuar në zona të caktuara.

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Çako!

Besoj se u konstatua qartësisht edhe nga pyetjet e kolegëve, edhe nga përgjigjet tuaja, që puna e emergjencave civile është një punë komplekse. Pikërisht, kompleksiteti është ai që nganjëherë ju bën juve përgjegjës direkt ose bën edhe institucione të tjera.

Dua të di: a kemi sot një listë të pikave të qyteteve ose të bashkive më të rrezikuara në Shqipëri për emergjencat civile? Sipas kësaj liste ose sipas kësaj harte, që ju tani e dispononi, me buxhetin vitit 2019 a kemi një reflektim në investime? Ishte një pyetje e koleges Gjebrea, dhe besoj se pyetja ishte e drejtpërdrejtë, dhe, në fakt, duam një përgjigje më të drejtpërdrejtë për të ditur konkretisht, nëse ju keni kërkuar që të bëhet një investim për t'i bërë parapritë një emergjence civile në një zonë të caktuar dhe për një arsye apo një tjetër, ai investim nuk është reflektuar në buxhet. Kjo do të ishte në interes për ne, si deputetë, që ta dinim.

Pyetja e dytë lidhet me një çështje tjetër. Natyrisht Ministria e Mbrojtjes si institucioni juaj epror, por edhe si institucioni përgjegjës, për shkak të ligjit, ka bërë një punë shumë të mirë me ndërtimin e urave të tipit bejli në zona, që, në fakt, janë rrezikuar ose e kanë pësuar për shkak të emergjencave civile ose fatkeqësive të ndryshme natyrore. Pikërisht për këtë çështje, për vitin 2019 a planifikon Drejtoria e Përgjithshme e Emergjencave Civile ndërhyrje në zona të tjera, ku ka mundësi që të bëhen ura të tipit bejli? A është marrë parasysh fakti, që aktualisht ne kemi zona, ku bashkitë nuk mund ta mohojnë që ka nevojë për t'u bërë ndërhyrje të tilla, por nuk kontribuojnë në bërjen e këmbëve të urave, që është një detyrim që u takon bashkive dhe nuk është një detyrim që i takon Ministrisë së Mbrojtjes? Natyrisht, kjo është pjesë e bashkëpunimit, nuk është juaja, por më intereson kjo gjë që ta di. Po bëj edhe unë njësoj si kolegët e mi, nuk dua të dal nga roli im i deputetes. Edhe unë jam deputete në qarkun e Beratit, ka një zonë aty, një njësi administrative, Lumasi, që është një zonë malore, shumë e vështirë, që njerëzve u duhet të kalojnë lumin jo një herë, por tri herë dhe në të gjitha ato pika sot nuk ka një urë dhe sapo vjen stina e dimrit mos të them edhe në pranverë, aty është shumë e vështirë që të shkosh në fshatra të ndryshme. Mendoj se ju e keni parasysh zonën që jam duke folur. Konkretisht, çfarë mund të bëjmë këtu? Si mundeni ju, me përgjegjësitë tuaja, të mobilizoni njësi të tjera, që ne t'u vijmë në ndihmë këtyre banorëve të këtyre zonave, sepse është viti 2019 dhe njerëzit nuk mund të përfitojnë dot nga ndihma të tilla, kaq të thjeshta, por të rëndësishme për jetën e tyre?

Haki Çako – Faleminderit, zonja kryetare!

Më lejoni të theksoj se lista e riskut për bashkitë dhe për prefekturat është e qartë. Sigurisht, kjo ka dalë në saj të fenomeneve dhe pasojave që kanë ardhur deri tani në mënyrë

kronologjike, por edhe prej disa vjetësh është e qartë, qoftë harta, qoftë dëmet që janë shkaktuar në zona të caktuara në bashki apo në prefektura, ku mund të theksojmë, sipas fatkeqësive që kanë ndodhur ose në drejtim të përmbytjeve, për shembull, qarqet më të rënduara ose me fenomenin më të theksuar të përmbytjeve kanë qenë Shkodra, Lezha, Vlora, Fieri, Lushnjë deri diku Gjirokastra. Pra, janë zona, që kanë lumenj, të cilët dalin nga kontrolli gjatë shirave të rrëmbyeshëm, kur intensiteti është shumë i lartë në zonë ku ata burojnë. Në disa bashki është duke u punuar intensivisht. Mund të them se Bashkia e Fierit ka bërë një projekt ambicioz me rehabilitimin e argjinaturës së Vjosës, ku janë angazhuar Forcat e Armatosura, por edhe bordi i kullimit dhe një sërë mjeteve të tjera për të rehabilituar deri diku. Por është e domosdoshme që edhe njësi të tjera të qeverisë vendore të kenë projekte të sakta dhe të qarta, pasi vlerat buxhetore që duhen mundësuar për të bërë punë të tilla janë shumë të larta dhe është e domosdoshme që të gjitha institucionet të hedhin aty detyrimet e tyre.

Unë thashë se Drejtoria e Përgjithshme e Emergjencave Civile që nga janari i vitit 2018 ka kaluar në përgjegjësinë e Ministrisë së Mbrojtjes. Në gjykimin dhe vlerësimin tim, por dhe mbi bazën e analizës së punës së bërë deri tani është një vlerë e shtuar për shkak se janë shtuar kapacitetet e burimeve njerëzore dhe teknike, por janë reduktuar edhe një sërë elementesh burokratike, të cilat ndikojnë drejtpërsëdrejti për investimet ose për ndërhyrjen emergjente në situata të caktuara. Në këtë kuadër, jemi duke trajtuar dhe duke e fokusuar, kryesisht ndihmën të rasteve emergjente të ndjeshme që kanë impakt te komunitetet. Këtu dua të theksoj se është në vëmendjen e veçantë të ministres së Mbrojtjes, por edhe tonën, çështja e ndërtimit të urave bejl për zgjidhjen e rasteve emergjente, për rrugëkalime të ndryshme të banorëve në zona të caktuara, që janë kritike për të kaluar nga një zonë në tjetrën. Ne kemi planifikuar një fond, që duhet ta adoptojmë, për të ndërtuar një numër të konsiderueshëm ura bejl në disa zona të caktuara.

Ermonela Felaj – A mund të kemi një shifër ose një shpërndarje ku mendohet se do të ndërtohet?

Haki Çako – Jemi ende në vlerësim, pasi një pjesë e tyre kërkon një dokumentacion në vend, por kemi në konsideratë të gjitha kërkesat që janë paraqitur për investimet dhe do ta marrim në konsideratë ndërhyrjen për të reduktuar këto lloj nevojash.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Janë prokuruar rreth 300 metra lineare elie, të cilat bëjnë elementet e urës bejl për t'i ndërtuar dhe besoj se do të zgjidhet një pjesë e konsiderueshme.

Ermonela Felaj – Faleminderit!

Urdhëroni, zoti Harusha!

Luan Harusha – Në qoftë se njësitë vendore nuk e parashikojnë buxhetin 3%, drejtorja juaj nuk ka fonde për të vazhduar rikonstrukcionin e pikave të rrezikut dhe të fatkeqësive natyrore. Si mund t’u përgjigjemi qytetarëve në qoftë se bashkia nuk e lë fondin?

Ermonela Felaj – Më lejoni ta jap unë përgjigjen. Këtë gjë duhet ta zgjidhim ne, normalisht, me këshilltarët tanë bashkiakë duhet t’i bëjmë njerëzit të vetëdijshëm për përgjegjësitë e tyre, sepse të jesh këshilltar bashkie nuk është një qokë, është një detyrim ndaj banorëve të komuniteteve ku janë zgjedhur. Për këtë arsye nuk duhet të kalojnë buxhete, të cilat nuk respektojnë detyrimet ligjore. Drejtori e tha, por edhe ministrja e Mbrojtjes që me ligjin e ri, që po punohet “Për mbrojtjen e civile”, natyrisht duhet t’i kushtohet rëndësi edhe aspektit të ndëshkimit të pasojës që u vjen kryetarëve të bashkive në rast se nuk i përgjigjen këtij detyrimi ligjor. Besoj se jemi të qartë. Aktualisht, drejtori nuk e ka këtë kuadër ligjor dhe nuk ndërhyt dot ndaj bashkive, që në vetvete janë një pushtet i zgjedhur dhe i pavarur.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në qoftë se e ke merak ta dëgjosh një përgjigje nga drejtori, patjetër, por them se është e qartë për ne.

Haki Çako – Në fakt, është një ngërç, të cilin ne e kemi marrë në konsideratë dhe e kemi trajtuar te draftligji dhe e kemi bërë taksative detyrimin e 4%-shit, i cili do ta imponojë njësinë vendore ta marrë në konsideratë. Më pas kur kalon përtej kapaciteteve, sigurisht janë detyrime që rriten për pushtetin qendror.

Ermonela Felaj - Ne duam që ky ligj të vinte sa më shpejt në parlament, sepse që nga koha që e filluam këtë sesion të kësaj legjislatore kemi qenë në pritje të këtij ligji. Sapo filloi kjo legjislaturë, ne shkuam vizitë te Drejtorja e Emergjencës Civile, dhe natyrisht që atëherë ka filluar për nevojën e pasjes së një ligji. Besoj se tani ka kaluar çdo afat që ne të vijojmë të flasim në kohën e ardhme, duhet që ta kemi në tavolinën tonë sa më parë këtë projekt.

Urdhëroni!

Ismail Shehu – Faleminderit!

Projektligji jo vetëm është shkruar në mënyrë taksative, që çdo bashkitë duhet të kenë një dysheme minimale për fondin e emergjencave civile, por janë vënë edhe filtra për ta garantuar këtë. Në rast se ndodh se një bashki nuk parashikon diçka të tillë, fillimisht është parashikuar që

institucioni i prefektit për bashkinë në varësi të mos kalojë projektbuxhetin vjetor pa qenë i parashikuar ky zë minimal për emergjencat civile. Përveç kësaj, është futur edhe roli i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë në mes, në qoftë se edhe me vendim perfekt nuk kalohet kjo, përsëri do të ketë një valvul tjetër sigurie, në mënyrë që të garantohet nga bashkitë, por edhe nga institucionet qendrore pasja e një buxheti minimal, sipas përcaktimit në ligj.

Ndërkohë, kemi edhe një variant ambicion, që del përtej ligjit, në mënyrë që të kemi mundësinë që ta angazhohemi edhe vetë, mbase Komisioni i Sigurisë, ose një komision tjetër parlamentar, për të qenë edhe ai një filtër ekstra për detyrimet që do të kenë institucionet, qoftë në nivel vendor apo në nivel qendror, për të parashikuar buxhete minimale për çështjet e mbrojtjes civile.

Ermonela Felaj – Zoti Shehu, më vjen mirë që e keni parashikuar, të paktën këto ishin edhe variantet që ne kemi diskutuar në mbledhjen e fundit me ministren e Mbrojtjes.

Urdhëroni, zoti Sinaj!

Vullnet Sinaj - Nuk e di, raportin që na bëri drejtori, a kemi këtu në komision me shkrim?

Ermonela Felaj – Ne kishim një seancë dëgjimore, por drejtori na e ka vënë dispozicion.

Haki Çako – Është depozituar në sekretari.

Ermonela Felaj – Faleminderit!

Besoj se kjo seancë dëgjimore na vlejti të gjithë kolegëve deputetë, natyrisht edhe të gjithë përfaqësuesve të institucioneve qendrore. Sot u ndërtua një punë më e mirë me emergjencat civile, në mënyrë që t'u vihet në ndihmë sa më shumë njerëzve që rrezikohen nga fenomene apo dukuri të ndryshme natyrore.

Faleminderit, zoti Çako, për prezencën!

Faleminderit përfaqësuesve dhe punë të mbarë!

MBYLLET MBLEDHJA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Sigurinë Kombëtare

PROCESVERBAL

Tiranë, më 13.11.2018, ora 10:30

Drejton mbledhjen:

Ermonela Felaj – kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

Seancë dëgjimore për nevojat buxhetore të Drejtorisë së Kufirit dhe Migracionit për vitin 2019.

Marrin pjesë:

Ermonela Felaj, Pjerin Ndreu, Xhemal Qefalia, Luan Duzha, Luan Harusha, Sadi Vorpsi, Vullnet Sinaj, Elona Hoxha, Anduel Xhindi, Klodjana Spahiu dhe Spartak Braho.

Mungojnë:

Andon Frrokaj, Luan Rama, Paulin Sterkaj, Myslim Murrizi, Ervin Saliangji, Flamur Noka, Endrit Braimllari, Xhemal Gjunksi dhe Isuf Çelaj.

Të ftuar:

Ndue Doci - Përgjegjës Sektori në Drejtorinë e Kufirit dhe Migracionit

Shpetim Ahmetaj – Përfaqësues i Drejtorisë së Kufirit dhe Migracionit

Pëllumb Aliaj – Përfaqësues i Drejtorisë së Kufirit dhe Migracionit

Valion Cenaliaj – Përfaqësues i Ministrisë së Financave

Ermonela Felaj - Viojmë mbledhjen e Komisionit Parlamentar të Sigurisë Kombëtare, sikundër e përmendëm edhe gjatë hapjes së kësaj mbledhjeje, si pikë të dytë të rendit të ditës është parashikuar seancë dëgjimore për nevojat buxhetore të Drejtorisë së Kufirit dhe Migracionit për vitin 2019.

Të ftuar kemi zotin Ndue Doci, përgjegjës Sektori në Drejtorinë e Kufirit dhe Migracionit, zotin Shpetim Ahmetaj, përfaqësues i Drejtorisë së Kufirit dhe Migracionit, dhe zotin Pëllumb Aliaj, përfaqësues i Drejtorisë së Kufirit dhe Migracionit. Mirë se keni ardhur!

Në fakt, kërkuam që të kishim një seancë dëgjimore me drejtuesen e këtij institucioni, por për arsye të axhendës së punës, drejtuesja e institucionit ndodhet jashtë punës, ndërkohë edhe ne kemi kalendarin tonë, që jemi të detyruar t'i përmbahemi. Kështu që, jemi të detyruar që ta zhvillojmë këtë seancë dëgjimore, por shpresoj të mundemi të diskutojmë të gjitha ato pika të nxehta që kemi konstatuar si deputetë të këtij komisioni parlamentar.

Në fakt, ky komision ka pasur një axhendë takimesh me disa nga drejtuesit e pikave të kalimit kufitar në vend, gjatë atyre takimeve ne kemi konstatuar një sërë problematikash për të cilat jemi të interesuar të dimë nëse kanë gjetur zgjidhje apo do të gjejnë zgjidhje me buxhetin e vitit 2019.

Konkretisht, unë po mundohem të bëj një renditje të tyre në mënyrë të përmbledhur. Kemi konstatuar që në pika të ndryshme të kalimit kufitar, deri tani kemi vizituar disa nga më të mëdhatë në vend, si pikën e kalimit kufitar në Kakavijë, në Qafë Thanë, në portin e Durrësit, që është një pikë shumë e madhe. Kemi vërejtur se ka mungesa në logjistikë. Pavarësisht se janë bërë përpjekje serioze për ta furnizuar policinë me mjete të reja, ka ende mungesa në mjete si për shembull: dylbi nate, kamera termike, dylbi dite, dedektorët *smart deck* që janë shumë të kufizuar për sa i përket numrit aktual që është në përdorim.

Po kështu në disa pika të kalimit kufitar ka mungesa të burimeve njerëzore, pra nuk punohet me kapacitete të plota njerëzore, gjë që e vështirëson punën e punonjësve të Policisë së Shtetit apo më saktë të Policisë së Kufirit. Në disa pika ka mungesë në infrastrukturë. Kam vërejtur se pavarësisht se godinat nuk janë pasuri të regjistruara në emër të institucionit që përfaqëson Ministrinë së Brendshme, por janë pasuri e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

Në buxhetin e vitit 2019 në disa pika ka ndërhyrje në infrastrukturën e godinave, por desha të sqarohemi: kjo ndërhyrje do të bëhet vetëm në pjesën e godinës që përdoret nga dogana apo ndërhyrja është për të gjithë godinën?

Një problem tjetër që kemi konstatuar është ai që lidhet me armatimin që në fakt, në disa raste rezulton të jetë i vjetër dhe nuk është i njëjtë për të gjithë trupën efektive të Policisë së Kufirit dhe Migracionit.

Një problem, por jologjistik apo infrastrukturor është edhe ai që kanë ngritur punonjësit e pikave të kalimit kufitar, nuk lidhet drejtpërdrejt me buxhetin, por është një moment që do të dëshiroja ta diskutojmë, fakti që punonjësve të pikave të kalimit kufitar u është hequr e drejta dhe detyrimi për të hetuar lidhur me veprat penale që ndodhin në pikat e kalimit kufitar, ndërkohë që më herët këtë kompetencë ato e kanë pasur dhe e kanë zhvilluar, por vërehet një lloj anormaliteti në këtë pikë. Ndoshta kjo nuk do të vlente për pikën e kalimit kufitar të portit të Durrësit, ku autoritetet e policisë, të prokurorisë dhe të gjykatës janë shumë më afër dhe mund të ndërhyjnë menjëherë me marrjen përsipër të kryerjes së hetimeve, por në pikat e tjera që kanë një distancë nga të gjitha këto institucione që përmenda ndërhyrja është edhe më e vështirë dhe në njëfarë mënyre mund të ndihmojë edhe në cilësinë e hetimit, duke mos qenë një ndërhyrje e menjëhershme.

Për këto probleme dhe të tjera që besoj do të na parashtroni, ashtu siç na keni vënë përpara këtë material të shkruar, do të doja të hapja këtë seancë dëgjimore me përfaqësuesit e institucionit të Drejtorisë së Policisë Kufitare dhe Emigracionit.

Faleminderit për prezencën!

Shpëtim Ahmetaj – Faleminderit, zonja kryetare e Komisionit!

Përsëritet të gjithë deputetëve, anëtarë të Komisionit për Sigurinë Kombëtare!

Ne jemi më tepër të nivelit teknik, por problemet kryesore që ju parashtruat do të trajtohen edhe nga ana jonë.

Me marrjen e shkresës nga ana juaj, të Komisionit për Sigurinë Kombëtare, pavarësisht punës që kemi bërë vazhdimisht që në hartimin e projektbuxhetit afatmesëm për të gjithë Policinë e Shtetit, si program i veçantë është edhe kufiri, migracioni janë evidentuar të gjitha problematikat që edhe komisioni juaj me të drejtë i ka parë në pikat e kalimit kufitar.

Nuk po zgjatem, meqenëse materialin e paraqita bruto të përgatitur për programin e kufirit dhe migracionit, si: qëllimin e tij, politikën, objektivat, produktet që prodhojmë. Dihet që të gjitha këto kërkojnë një mbështetje logjistike, qoftë në burimet njerëzore, qoftë në ato materiale dhe financiare.

Në projektbuxhetin e vitit 2019 nga ana jonë është kërkuar herë pas here, meqenëse jam edhe pjesë e Policisë Kufitare dhe Migracionit dhe po trajtohet i veçantë programi “Policia Kufitare dhe Migracioni”. Është në dukje ajo që prezantohet edhe në arenën ndërkombëtare.

Nga ana jonë për vitin 2019 kemi paraqitur në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, në Ministrinë e Brendshme dhe në Ministrinë e Financave duke dhëna argumente faktike dhe me *fish project* për të gjitha kërkesat tona me mjete logjistike dhe në veçanti me pajisje speciale që kanë të bëjnë me kufirin dhe migracionin. Konkretisht, një pjesë e tyre janë marrë parasysht nisur edhe nga limitet buxhetore, por një pjesë e tyre është lënë mbi limit ose në kërkesat shtesë, për të cilat do të kërkojmë nga Komisioni për Sigurinë, të paktën në nivelin që përfaqësojmë ne, të merren parasysht, sepse janë kërkesat më kryesore që kanë të bëjnë me mbarëvajtjen e punës në Policinë Kufitare për Migracionin. Në veçanti bëhet fjalë për radarët, meqenëse është bërë edhe problem kjo pjesë.

Nga ana jonë është bërë një studim shumë i thellë, analitik dhe një testim për vendosjen e radarëve, sepse që në vitin 1998 radarët nuk kanë qenë në nivelet e kërkuara. Kemi bërë një studim dhe një *fish project* e kemi paraqitur në ministrinë tonë dhe atë të Financave që ka një efekt financiar në vlerën prej 405 milionë lekë të rinj ose rreth 3 milionë. Do të ishte shumë e domosdoshme që ne ta mbrojmë këtë gjë si kërkesë shtesë. E paraqita si të parë meqenëse është prioritet, është prezantuar, nuk është në limitet buxhetore, por është në kërkesat shtesë.

Në projektet që kemi paraqitur për mjetet logjistike për t’u ardhur në ndihmë kufirit dhe migracionit kemi kërkuar pajisje speciale, ashtu siç e kemi paraqitur edhe në materialin për komisionin tuaj, edhe për lexues optikë për pasaporta që kanë qenë problematike. Për vitin 2019 janë marrë parasysht dhe do të futen në limitet buxhetore për kompletimin e të gjithë pikave të kalimit me lexues optikë.

Kemi kërkuar skaner për kontrollin e bagazheve, dylbi nate, dite, sepse janë specifike dhe kanë vlera të mëdha, si edhe radarët dixhitalë stacionerë që montohen.

Këto janë vlerësuar nga ana jonë jo vetëm thjesht nga materiali, sepse ai erdhi vonë, por që në hartimin e fazës së parë të projektbuxhetit afatmesëm, i kemi prezantuar dhe i kemi mbrojtur deri në fazën e dytë në periudhën korrik-gusht, me përcaktimin e prioritetëve një pjesë e tyre kanë kaluar në kërkesat shtesë. Një ndër to është edhe blerje për motorë të mjeteve lundruese që është një projekt në vazhdim. Një sukses për këtë vit ishte se u blenë 6 motorë për mjete lundruese, sepse kanë qenë shumë problematike. Mjetet lundruese i kishim pothuajse të

amortizuara dhe jashtë përdorimit. U bë e mundur që me miratimin e buxhetit të vitit 2018 të realizohej ky projekt. Kemi kërkuar që edhe në vazhdim të kemi blerje për motorë, mjete lundruese të nivelit të lartë që kanë vlera të mëdha. Për pajisjet speciale me kërkesat që kemi ne edhe në vitin 2019 është miratuar një fond, jemi të kompletuar, të paktën një përqindje e mirë për të mbyllur problematikat që kemi në pikat kryesore.

Në pikën e dytë, meqenëse e trajtuar në material po i referohem asaj, për sa i përket mungesës së burimeve njerëzore, kemi bërë një studim, një projekt dhe kemi kërkuar rreth 500 punonjës shtesë për kufirin dhe migracionin, me argumentet që ju me të drejtë i kishit trajtuar në material se cili është numri i punonjëseve që duhet për kilometra sipërfaqe. Janë kërkuar 500, janë dhënë argumentet, janë bërë përllogaritjet, janë nxjerrë defektet financiare. I kemi edhe me listë. Nuk e di nëse i paraqitëm pranë jush. Na është premtuar se në vitin 2019 dhe në vazhdim Policia e Shtetit do të ketë shtesë të burimeve njerëzore, ndër to do të ketë edhe Policia Kufitare dhe e Migracionit. Nëse do të merret parasysh kjo gjë, do të jetë në nivele më të mira dhe mbulimi me burime njerëzore.

Në material, në ato që kemi trajtuar, ka mungesë të infrastrukturës së godinave. Në këtë drejtim kemi bërë përmirësime të dukshme, është e vërtetë, por investimet edhe nga vlerat e tyre, janë të larta dhe jemi munduar që një pjesë të mirë të tyre t'i mbulojmë me donatorë. Po të shikojmë janë disa projekte që kanë përfunduar dhe po vazhdojnë dhe mendojmë se do të jenë të suksesshme edhe për pikat e tjera të kalimit kufitar.

Në vitin 2018 përfunduan pika e kalimit kufitar Morinë, me financimet e huaja të BE-së, pika e kalimit kufitar e Hanit të Hotit, ku ka kontribuar edhe buxheti i shtetit me kompletimin me pajisje. Është miratuar edhe një fond për ndërtimin e godinës për pikën e kalimit kufitar në vlerën 40 milionë lekë të rinj. Pra, mendojmë se kjo pikë, e Morinës është ezauruar.

Një projekt tjetër i rëndësishëm që është në vazhdim, në fazën e hartimit të lidhje së kontratës, është pika e kalimit të Qafë Botës, e cila ka qenë në nivel përfaqësimi të nivelit të lartë të drejtorit të Përgjithshëm të Kufirit dhe të nivelit teknikien. Ata kanë qenë në bashkëpunim me Policinë Kufitare greke, kanë zhvilluar takime dhe është miratuar fondi prej 2 milionë eurosh për financimin e kësaj pike. Ne kemi një kontribut nga buxheti i shtetit në vlerën 40 milionë të rinj, si bashkëfinancim. Pra, ka përfunduar lidhja e kontratës dhe në vitin në vazhdim do të fillojë zbatimi i këtij projekti, i cili duket shumë i rëndësishëm. U kërkuar nga palët dhe nga BE-ja që të

përzgjidhet se cila do të jetë pika e kalimit, u diskutua dhe u vendos që të jetë Qafë Bota një nga këto pika.

Në projektbuxhetin e vitit 2019 janë planifikuar dhe shërbime, në nivelin e investimeve kapitale, kemi artikullin “shërbime operationale”, kanë fonde të gjitha drejtoritë vendore, janë 12 njësi shpenzuese, që ka Departamenti për Kufirin dhe Migracionin, janë të kompletuara për sa u përket fondeve për pagat, sigurimet shoqërore dhe shpenzimet operationale për “mallra dhe shërbime”, me përjashtim të investimeve që kanë probleme në pajisje.

Vit pas viti dhe gjatë vitit me kërkesat që kanë pasur të gjithë njësitë buxhetore, edhe në nivelin e shefit të Financave që unë përfaqësoj, kërkesat janë plotësuar nisur nga eksperiencia që buxheti ka limitet buxhetore, por nuk është e thënë që është statik dhe është i pandryshueshëm. Me kërkesat që kanë pasur njësitë buxhetore janë plotësuar me rialokimet që kemi pasur. Nisur nga kjo, buxheti i Policisë Kufitare dhe Migracionit në nivelin e përgjithshëm është i kompletuar me përjashtim të pjesës së investimeve kapitale, që janë blerja e mjeteve lundruese, radarët që janë problematikë dhe pajisjet speciale për kompletimin e këtyre pikave të kalimit kufitar.

Për pjesën e armatimit edhe nga ana jonë është evidentuar dhe me inventarët që janë bërë, me seleksionimet dhe me studimet, nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit është planifikuar një fond buxhetor në vlerën 100 milionë lekë të rinj, rreth 25% e armatimit do të zëvendësohen që këtë vit. Për vitin që vjen krahas Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, do të bëhet rinovimi i armatimit dhe i pajisjeve të armatimit në Drejtorinë e Kufirit dhe të Migracionit.

Meqenëse kemi edhe shefin e Sektorit e Operacional që mbulon kufirin, kjo është e nivelit politik, është e drejtë ajo që heqja e hetimit është pjesë e politikës dhe nuk mund të ndërhyjmë fare. Megjithëse jam me gradë policore do të ishte e drejtë që ta kishte vetë hetimin Departamenti i Kufirit dhe Migracionit. Nëse bëhet kjo do të jetë gjë shumë e mirë, sepse punonjësit, personeli janë, por edhe problematikat janë të drejtpërdrejta te kufiri dhe migracioni.

Në nivel teknik mund të flasë edhe shefi përkatës. Ka qenë dikur, u kërkua me insistim, u vendos dhe nuk e di pse u hoq sivjet nga struktura e Policisë së Kufirit dhe Emigracionit.

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Ahmetaj!

Me thënë të drejtën nëpër komisionet parlamentare është kërkesë e vijueshme që përfaqësimi të jetë në nivel politik, por kjo nuk do të thotë që përfaqësimi në nivel teknik nuk është i domosdoshëm, përkundrazi, ndonjëherë bëhet shumë i domosdoshëm për faktin që ju jeni

aty ku ndjeshmëria është më e madhe, jeni njohësit më të mirë të nevojave që kanë institucionet, por edhe njerëzit që mund të na jepni informacion më të plotë dhe më të detajuar lidhur me shkallën e plotësimit të këtyre nevojave. Pra, sinqerisht besoj se me të gjithë kolegët e vlerësojmë faktin që kemi rast të bisedojmë me përfaqësues teknikë, por edhe ju keni mundësi të shpreheni drejtpërdrejt para një komisioni parlamentar.

Zoti Doçi, doni të ndërhyini? Nëse po, keni fjalën.

Ndue Doçi - Faleminderit!

Përsëritet!

Në lidhje me heqjen e të drejtës së hetimit të veprave penale Departamentit të Kufirit dhe Migracionit, dua t'ju informoj se këtë të drejtë Policia Kufitare dhe e Migracionit e ka pasur që nga viti 2010 deri në maj të vitit 2018, kur filloi implementimi i strukturës së re të Policisë së Shtetit.

Ne hetonim 16 vepra penale, të cilat kryesisht kryheshin në pikën kufitare, në vijën kufitare ose në afërsi të tyre. Heqja e kësaj të drejte, shkurtimi i limitit organik e bën të pamundur që të ketë atë efikasitet që kishte më parë hetimi i këtyre veprave penale, sepse është ndryshe kur janë specialistë, do të hetojnë veprën penale dhe ndryshe një punonjës i zakonshëm i Policisë Kufitare që do të bëjë thjesht patrullimin. Vlerësimi që mund t'i bëjë ai vendit të ngjarjes është i ndryshëm në të dyja rastet. Është një problem që është konstatuar menjëherë pas implementimit të strukturës, drejtoresha e Departamentit e ka bërë prezent edhe te drejtori i Përgjithshëm dhe po punojmë me drejtorin e Personelit dhe të Burimeve Njerëzore që të gjejnë një modalitet që kjo gjë të kthehet përsëri, se janë 16 vepra penale, të cilat në këto momente që flasim janë në mëshirë të fatit.

Ermonela Felaj - Zoti Doçi, me sa kuptohet kjo është për shkak të ristrukturimit që ka ndodhur brenda Policisë së Shtetit, por sidoqoftë paraprakisht mund t'ju vë në dijeni se në një takim jo formal që kemi pasur me zëvendësministrin e Brendshëm, zotin Lleshi ia kemi parashtruar këtë problematikë dhe kemi kërkuar vëmendjen e tij që hetimi t'u rikthehet pikave të kalimit kufitar për ato vepra penale që lidhen me kalimin në pikat e kalimit kufitar në vetvete. Arsyeja është më se logjike, kërkesa është më se e natyrshme për shkak se këto pika me personelin që kanë dhe janë investuar në vite në hetimin dhe ndjekjen e këtyre veprave penale, sigurisht që janë profesionalizuar në këtë pikë, është një vlerë, e cila kurrsesi nuk duhet të humbasë, së pari, përveç atyre të tjerave që i përmendëm.

Unë dua t'ua kaloj fjalën edhe kolegëve, për të zgjeruar diskutimin midis nesh.

Po, zoti Harusha.

Luan Harusha- Faleminderit, zonja kryetare!

Gjatë kontrollit që kemi bërë në pikën kufitare të Qafë Botës, pamë se nuk kishte një skaner për kontrollin e kamionëve. Ky ishte një problem.

Ermonela Felaj- Besoj se flet për skanimin e mjeteve të tonazhit të rëndë, skanimi që bën “Rapiskan”-i, por ajo është pjesë e kontratës, në fakt që qeveria ka me shoqërinë “Rapiskan”.

Luan Harusha – Pra, është një pjesë e problemeve të punës së tyre.

Ermonela Felaj- Nuk është tamam problem i punës së tyre, sepse skaneri është vendosur vetëm në disa pika të mëdha të kalimit kufitar, aty ku kalojnë mjete të rënda. Pika e Qafë Botës nuk është nën nivelin e pikave të tjera për nga numri i lëvizjeve, transaksioneve që kryen. Shifrat e tarifës doganore që realizohet aty, me të dhënat që na u thanë në atë pikë kalimi kufitar, me mbylljen e rrugës Igumenicë-Qafë Botë, aksin Kardhiq- Delvinë do të bëhet e mundur që Qafë Bota të marrë po atë të peshë dhe rëndësi, ndoshta dhe më të madhe sesa Kakavija në vetvete.

Për momentin nuk ishte kjo.

Ndërkohë dëgjova nga zoti Ahmetaj që disa nevoja janë reflektuar. Më gëzon fakti që konstatoj ndjeshmëri të njëjtë në nevojat që kanë këto pika.

Luan Harusha - Doja të thosha edhe diçka tjetër, nga konstatimi i pikës kufitare kemi vënë re se ambienti atje lë për të dëshiruar. Sa hyn në territorin e Republikës së Shqipërisë shikon pemët e paprera, bari i thatë. Të mendohet nga ana e drejtorisë tuaj për një personel të mirëmbajtjes në bashkëpunim me doganat, me Policinë e Shtetit për territorin në pikat kufitare.

Ermonela Felaj - Po, zoti Ahmetaj.

Shpëtim Ahmetaj – Ne kemi marrë dhe zotin Aliaj, i cili është drejtor i Shërbimeve Logjistike për të gjithë Policinë e Shtetit. Me të drejtë thamë, që ta kishim mbështetje, ta kishim prezent, për të gjitha problematikat, për ato që do të kërkohen edhe nga ana juaj.

Zoti Aliaj mund të flasë edhe për këtë gjë.

Ermonela Felaj - Po, zoti Aliaj.

Pëllumb Aliaj - Përshëndetje!

Nëse do të diskutojmë për këtë pyetje, unë po i përgjigjem. Nëse bëhet fjalë për Qafë Botën, e kemi në projektin që do të fillojë në vitin 2019 dhe do ta bëjmë me të gjithë aksesoret e nevojshëm që ajo pikë kufitare të funksionojë më mirë sesa këto ekzistueset.

Për të tjerat ne kemi parashikuar që në bashkëpunim me doganat të krijojmë një njësi shërbimi me kontraktues, sepse nuk mund të kemi.

Është e vërtetë, ajo është një gjë që ndoshta duhej bërë më parë, por ka dalë si problematikë dhe ka nevojë për mirëmbajtje të vazhdueshme, qoftë edhe për gjelbërimin, pastrimin e të tjera.

Kemi parashikuar dhe jemi në tratativa të mbyllim marrëveshjen e të vendosim pjesën që do të financojmë, se mund t'i ndajmë me pika ose me pjesë buxheti dhe ta bëjmë tenderin.

Lidhur me kërkesën për radarët, mund të them se është një problem që ne e kemi evidentuar dhe duam ta përmirësojmë, por jemi të ndërgjegjshëm se shifra për përmirësimin e atyre radarëve, se nuk duam të bëjmë më radarë stacionarë, që njëherë punon e njëherë jo, por kërkojmë të bëjmë radarë të integruar me teknologjinë bashkëkohore, të cilët të kontrollojnë të gjithë pjesët, edhe më të futurat e kufirit blu dhe të japin informacion të sigurt, shkon te 400 milionë. Ky është projekti i plotë se ne kemi edhe projekte të tjera, por diku do të lëmë e diku do të financojmë.

Kemi kërkuar ta fusim si projekt, të sigurojmë një fond që të arrijmë në kufirin 201% të vlerës totale të projektit që të mund të bëjmë procedurën e prokurimit dhe jo 400 milionë njëherësh, por të marrim për shembull 50 apo 80 milionë, sa të bëjmë procedurën, në mënyrë që të vazhdojmë më pas.

Po kështu edhe me shtesat që kemi kërkuar për 500 punonjës. Ne e kemi kërkuar këtë për një periudhë deri në vitin 2022, në mënyrë që të arrijmë normativat që kanë vendet e BE-së për numrin e punonjësve të policisë për banor.

Shpresojmë që për vitin 2019, sipas rakordimeve që kemi bërë me Ministrinë e Financave, të na shtohet numri i punonjësve dhe prioriteti ynë është që këtë shtesë punonjësish ta destinojmë për kufirin, ku vërtet ka nevojën për intensifikim forcash policore.

Lidhur me armatimin, theksoj se kemi një projekt të madh për armatimin. Këtë vit janë financuar rreth 72 milionë lekë të reja, sepse kemi trashëguar armatim që nuk u përshtatet më standardeve të policive europiane.

Për këtë vit kemi një kontratë nga e cila sigurojmë një numër të konsiderueshëm armatimi (bëhet fjalë kryesisht për pistoletë), do t'i zëvendësojmë një pjesë dhe 25% do të rinovojmë armatimin e kufirit brenda muajit dhjetor.

Për vitin 2019 kemi përsëri 100 milionë lekë në buxhet dhe shpresojmë që me kursime nga prokurimet të financojmë edhe më shumë se 100 milionë, me synimin që strukturat e kufirit,

në fund të vitit 2019 të arrijnë të rinovohen në mbi 50% të tyre. Është një shifër e konsiderueshme prandaj ne e quajmë arritje këtë.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Urdhëroni, zoti Xhindi!

Anduel Xhindi - Faleminderit!

Kam një pyetje. Si është fluksi i azilkërkuesve në vendin tonë dhe çfarë masash kemi marrë ju për menaxhimin e kësaj situate?

Faleminderit!

Shpëtim Ahmetaj – Me statistikën që kemi, fluksi i azilkërkuesve në vendin tonë, në krahasim me vendet e tjera, nuk ka qenë shumë i lartë. Kjo nisur nga numri i personave të ndaluar, me dokumente të parregullta, që janë në Qendrën e Trajtimit të të Huajve, në Kareç. Aktualisht atje janë 40 të huaj. Numri më i madh ka qenë deri në 100 persona, por ky ka qenë një rast i rrallë, se niveli mesatar i tyre është nga 20 deri në 30 persona të ndaluar, sepse fluksi mund të jetë i lartë, por problematika është e tillë që, meqenëse në pikat e kalimit kufitar të gjithë këta persona ndalohen, kontrollohen dhe nëse ata nuk plotësojnë kushtet, qoftë për azil, qoftë për t'u sistemuar në Qendrën e Trajtimit të të Huajve, kthehen në vendin e tyre të origjinës.

Në Gjirokastrë ne kemi një qendër të tillë në Gërrhot. Kemi edhe Qendrën e Trajtimit të të Huajve në Kareç, në të cilën janë bërë investime rreth 2 milionë euro të investuara nga BE-ja. Është pjesë e departamentit të kufirit dhe trajtimi bëhet në mënyrë të rregullt me ushqime, me uniformë me të gjitha nevojat e tjera.

Avokati i Popullit ka bërë kontrolle për mënyrën e trajtimit të tyre, gjithashtu edhe përfaqësues të BE-së. Është bashkëpunuar me UNCHR-në për të na mbështetur me logjistikë dhe pajisje.

Probleme do të ketë patjetër, përderisa ato vijnë nga jashtë dhe duan të ikin diku tjetër, por për pjesën që është ndaluar dhe janë grumbulluar nëpër qendra u është bërë trajtimi i plotë.

Mbështetja nga buxheti i shtetit ka qenë e plotë, sepse kjo nuk është e përhershme, ka flukse në rënie, por ato që kanë qenë janë trajtuar sipas të gjitha kushteve dhe sa herë kemi kërkuar fonde për këto raste, kemi pasur mbështetje.

Ermonela Felaj – Po e plotësoj pyetjen e zotit Xhindi.

Ne e konstatuam si problem, në fakt, në pikën e kalimit kufitar Kakavi, që shpeshherë nuk shfrytëzohen qendrat, ku duhet të trajtohen azilkërkuesit, po të gjithë grumbullohen në Tiranë.

Edhe ju vetë sapo e pohuat se është ndërtuar një qendër shumë e mirë në Kareç (besoj se do të kemi rastin në ditët në vijim të shkojmë e ta vizitojmë), por fakti që ju përmendni një vlerë investimi 2 milionë euro nga BE-ja më bën të kuptoj se duhet të jetë një qendër me parametra shumë të mirë. Besoj se duhet të ndërhyjmë që t'i bëjmë të gjithë këto qendra efektive, në mënyrë që shpenzime të tilla të mos vlejné thjesht dhe vetëm për bukuri, por të vlejné për të trajtuar njerëz që vijnë nga rajone të nxehta dhe që e përdorin Shqipërinë si pikë kalimi transit.

Shpëtim Ahmetaj – Me qenë se numri i të trajtuarve nuk është shumë i lartë, në mënyrë që të investohet, sepse investimi dihet se ka një vlerë të konsiderueshme, është diskutuar që, edhe nga bashkëpunimi me BE-në, azilkërkuesit të jetë të përqendruar në Tiranë, meqenëse është më afër qendrës.

Të gjitha njësitë buxhetore kanë fonde për trajtimin e tyre, ndaj ne disa herë me të drejtë kemi kërkuar të planifikohen fonde, por meqë nuk ka pasur të trajtuar në këtë rast, mungesa e fondeve ka bërë që ata të përcillen urgjent në Tiranë, sepse të vijnë në Tiranë dhe të kthehen prapë në Greqi ka një kosto të konsiderueshme për trajtimin dhe transportin. Gjithsesi, drejtori i shërbimeve logjistike mund të flasë.

Ermonela Felaj – Urdhëroni, zoti Aliaj!

Pëllumb Aliaj – Ideja e këtyre qendrave është për të përballuar fluksin, që në bazë të marrëveshjeve, azilantët të trajtohen për një ose dy ditë, pra deri në 24 orë, sepse në bazë të marrëveshjeve që kemi, andej nga vijnë duhet të kthehen. Pastaj pjesa që ka më shumë probleme, të cilët nuk kthehen, ne duket t'i trajtojmë aty ku janë krijuar të gjitha kushtet, sepse në të gjitha pikat e kalimit kufitar jemi të ndërgjegjshëm se këto qendra nuk mund të funksionojnë në normalitet, edhe kur nuk ka njerëz.

Ishte një periudhë kur pati një fluks shumë të madh nga Kakavia dhe në bashkëpunim me UNHCR-në u ndërtuan godinat, të cilat kanë funksionuar (e kanë kryer rolin e tyre), deri sa janë bërë procedurat për rikthim në Greqi.

Tërë problemin e kemi pasur me shtetin grek, se që andej na kanë ardhur azilkërkuesit. Pjesën e azilkërkuesve që ka pasur nevojë të trajtohej më shumë se 24 orë e kemi sjellë në Tiranë, se ajo është një qendrën e plotë dhe i plotëson të gjitha kushtet.

Ermonela Felaj - Faleminderit!

Urdhëroni, zonja Gjebrea!

Elona Gjebrea – Në fakt, ajo që është parë në vitet e fundit është se ka ndryshuar fluksi dhe përqendrimi i personave që vijnë në këto qendra. Në qoftë se dikur qendra ka e Kareçit ka qenë më shumë persona dhe ka pasur më pak qendra për trajtimin e refugjatëve, tani ka ndryshuar trendi, ka më shumë persona, të cilët kërkojnë azil ndoshta duke shfrytëzuar legjislacionin tonë për të pasur mundësi edhe për të lëvizur dhe ka më pak persona që nuk pranojnë të kërkojnë statusin e refugjatit dhe për rrjedhojë ata kapen si të ndaluar të parregullt në qendrën e Kareçit.

Në këtë këndvështrim, ndoshta ka ardhur koha që të rishikohet pak edhe statusi i punonjëse që janë aty. Në qoftë se ka shumë punonjës në qendrën e Kareçit dhe ka më pak te qendra e refugjatëve, mbase duhet riparë kjo, duke parë se sa persona kemi ne në vit, që të gjejmë një mesatare.

Ndërkohë, ajo që më bën përshtypje është numri i punonjësve që ju keni te zëri buxhetor. Pra, Drejtoria Vendore Korçë ka numrin më të lartë të punonjësve, ndërkohë që me fluksin e punës, kjo mund të krahasohet me Gjirokastrën, e cila ka një fluks të shtuar.

Pra, pas Korçës është Durrësi me numrin më të lartë të punonjësve, Tirana, pastaj vjen Gjirokastra e kështu me radhë.

Besoj se keni bërë një analizë, po a reflektohet mirë numri i punonjësve me ngarkesën që kanë departamentet përkatëse?

Ashtu sikurse është prioritet lufta kundër trafikeve të paligjshme, ndoshta ka ardhur koha të kërkojnë më shumë fonde dhe jo t'ua lëmë viteve buxhetore pasardhëse buxhetimin përkatës për këtë çështje. Mendoj që ne do ta kemi sfidë edhe këtë vit çështjen e emigracionit të paligjshëm.

Faleminderit!

Ermonela Felaj - Faleminderit!

Urdhëroni, zoti Ahmetaj!

Shpëtim Ahmetaj - Faleminderit!

Çështjen e parë e sqaruar vetë. Qendra e Mbyllur për të Huajt, siç e ka emërtimin, merret me trajtimin e të huajve që janë pa dokumente ose me dokumente të parregullta. Nisur nga numri i tyre, që ka qenë në rënie, është lënë që ajo qendër të funksionojë dhe numri i punonjësve atje ka ardhur duke rënë.

Aktualisht atje operojnë 19 punonjës me status policor dhe 10 punonjës me status civil, të cilët janë sanitarë, kuzhinierë, mirëmbajtës etj., dhe është kërkuar shtimi i tyre nga Avokati i

Popullit apo nga organizata të tjera, por ne e kemi parë të mjaftueshëm, sepse një pjesë të mirë e kemi mbuluar ne si departament, me punonjësit tanë.

Aktualisht, departamenti mbulon Kareçin me financë, me logjistikë dhe me personel. Kam frikë se duke i shkurtuar këto punonjës puna do të çalojë dhe nuk do të realizohen detyrat.

Për sa i përket Korçës, numri i punonjësve atje është vendosur në bazë të sipërfaqeve dhe kilometrave që mbulojnë. Dihet se Korça ka një shtrirje territoriale shumë të madhe, duke filluar që nga Qafë-Thana deri në Leskovik, prandaj është e domosdoshme organika dhe struktura e përcaktuar e tyre.

Pikërisht këto janë pika që kanë kërkuar shtesa organike. Ndërsa Gjirokastra ka Kakavijën, Saranda ka komisarjat më vete, kështu që shtohet numri, prandaj me të drejtë është kërkuar, se po të shikosh numrin e përgjithshëm të punonjësve të Policisë Kufitare si program është 15% e numrit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit. Unë, jo pa qëllim i kam vendosur edhe përqindjet poshtë, duke i krahasuar me Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit.

Faleminderit!

Elona Gjebrea – Sa për qind ka rritje të punonjësve krahasuar me vitin e kaluar?

Shpëtim Ahmetaj – I kam statistikën. Ka dy vjet që nuk ka ndryshuar numri. 300 punonjës janë shtuar në krahasim me vitin 2017.

Ermonela Felaj – Urdhëroni, zoti Sinaj!

Vullnet Sinaj – Në radhë të parë vlerësoj punën e Forcës së Kufirit si një nga detyrat e shenjta dhe të vështira, sepse funksionojnë në skajet e vendit dhe përplasen me problematika të ndryshme të njerëzve që mund të kryejnë vepra në vendin tonë, të largohen apo atyre që duan të hyjnë.

Lidhur me këto që po diskutojmë unë doja të dija kë quani ju “fish- project”?

Formularët e identifikimit të projektit, i cili ka financim.

Kemi paraqitur një fish-project për blerjen e 200 lexuesve optikë të pasaportave, që kushtojnë 26 milionë lekë.

Shpëtim Ahmetaj – Absolutisht, këto janë bërë mbi bazën e testimi të tregut. I takon 1 milionë e 300 mijë lekë një lexues.

Pra, i bie që për numrin e pikave kufitare që kemi i bie rreth 25...

(Diskutime pa mikrofon)

Vullnet Sinaj – Keni parashikuar blerjen e 8 lexuesve për pikë? Ne kemi vizituar këto pikat kufitare dhe nuk kemi parë 8 poste pune në një pikë. Për shembull në Qafë- Botë unë nuk vura re që të kishte nevojë kaq të madhe. Ata kishin nevojë për një apo dy lexues, por jo për 8. Më duken shumë parashikimi.

Shpëtim Ahmetaj – Këto janë kërkesa që kanë ardhur nga verifikimet dhe nga kërkesa që u kemi dërguar të gjithë drejtorive vendore të kufirit. Ne jemi thjesht kostoistë dhe bëjmë përlllogaritjen e të gjitha kërkesave që vijnë nga niveli operacional. Në bazë të kërkesave ne kemi parë me vend që të blihen kaq lexues optikë.

Vullnet Sinaj – Ju kemi ardhur në komision për të na dhënë një informacion. Nuk mund të vini këtu vetëm me ato që ju thonë, por duhet t’u bëni një vlerësim kërkesave që ata ju sjellin, mendoj unë.

Pika tjetër që doja të theksoja është se ju këtu në fund shkruani: “Përgatitja e dokumentacionit në bashkëpunim me Policinë Kufitare Greke për fondin e BE-së për pikën kufitare Qafë- Botë, që është në vlerën 2 milionë euro”. Kjo shifër është vetëm për palën tonë? Çfarë keni parashikuar në këtë projekt, se shoh që kontrata do të bëhet nga një sipërmarrës i zgjedhur nga BE-ja?

Me qenë se e kemi vizuar atë pikë kufitare, do të donim të dinim më hollësisht se çfarë është parashikuar në investimet që do të bëhen me këto lekë të dhëna nga BE-ja?

Faleminderit!

Pëllumb Aliaj - Faleminderit!

Ky është një projekt që financohet nga BE-ja dhe 2 milionë euro është i gjithë projekti. Këtu nuk është përfituese vetëm Policia Kufitare, por edhe Dogana. Parashikohet të bëhet një kompleks që do të funksionojë për Doganën dhe Policinë Kufitare me të gjithë aksesoret e nevojshëm, edhe me ambientet, edhe me pajisjet edhe për kontrollin e makinave.

Pjesën më të madhe e ka financimi i BE-së. Ne kemi pjesën e bashkëfinancimit dhe ne si polici kemi vetëm 40 milionë lekë, nga të cilat 23 milionë janë pjesa e bashkëfinancimit dhe pjesa tjetër është TVSH-ja. Kryesisht e ka dogana si projekt. Ata do të jenë edhe përfituesit që do ta marrin në administrim.

Projekti është bërë komplet me të gjitha nga pala greke. Ata kanë qenë iniciatorët.

Në lidhje me çështjen e 200 lexuesve optikë, po ju sqaroj se kërkesat janë bërë shumë të llogaritura dhe mbi bazën e specifikimeve teknike. Aktualisht, lexuesit optikë që kemi nëpër pika

nuk funksionojnë normalisht, janë thuajse të amortizuar, sepse ashtu janë blerë që në fillim dhe kanë dalë probleme. Ka kaluar pasaporta dhe nuk është lexuar me të gjitha të dhënat e saj. Nuk ka asnjë lloj... Mbase ne tregohemi të kufizuar, për shkak të mundësive që kemi në buxhet.

Pse janë 8? Janë 8, sepse pavarësisht se do të blihen detektorë të rinj, kjo nuk do të thotë se ata nuk do të kenë defekte. Nëse do të prishen 1 apo 2 detektorë në një pikë kufitare, sa të rregullohen ato duhet të funksionojë pika tjetër, sepse në shumicën e rasteve ato janë pika që funksionojnë 24 orë dhe nuk duhet të ketë mungesë të detektorëve.

Anduel Xhindi – Këtë gjë e vumë re kur shkua për vizitë në pikat kufitare. Ata e kishin problem punën e lexuesve. Është kërkesa tyre, sepse nuk pashë 8 pika kontrolli në të njëjtën kohë, që të kalonin në kontroll. Megjithatë, kjo është puna juaj.

Në Qafë-Botë morëm vesh se policia jonë kufitare punon me tri turne, edhe natën, kurse pjesa e Greqisë nuk punonte me tri turne. Ka ndodhur që në rastet e zakonshme të fluksit të turistëve që vinin drejt vendit tonë, ata mund ta kalonin pjesën tonë, por rrinin nga pjesa greke. Kjo nuk funksionon.

Brenda investimit prej 2 milionë eurosh, a keni marrë masa apo i keni shprehur ndonjë kërkesë nëpërmjet Ministrisë sonë të Brendshme qeverisë greke apo ministrisë greke, që përgjigjet për kufirin, që ta bëjnë edhe ata me tri turne pikën e Qafë-Botës, që të krijojmë mundësinë që turistët të lëvizin sa më lirshëm?

Dëgjova që u fol shumë për armatimin. Në fakt, armatimi duhet, por tani më shumë ka ardhur koha e turistëve sesa e armëve .

Faleminderit!

Pëllumb Aliaj –Faleminderit juve!

Ne e thamë që në fillim, ky është një projekt i iniciuar nga Bashkimi European. Pala greke ka qenë iniciatore. Atje i kemi zhvilluar edhe takimet për të rakorduar. Ne përzgjedhëm pikën, ata na e ofruan. Janë ata që e kanë propozuar dhe do t'i marrim të gjitha... Nuk bëhet fjalë që ne të funksionojmë me tri turne, siç jemi tani, kurse ata... Ata do të funksionojnë njëlloj si ne dhe ata janë më të interesuar se ne, në kuptimin e bisedave që kemi bërë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, po, me tri turne, nuk diskutohet.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Po, zoti Harusha.

Luan Harusha – Kisha dy pyetje.

Sa për qind e buxhetit është realizuar në vitin 2018?

Këto kërkesa janë të sivjetshmet apo të vitit që kaloi?

Pëllumb Aliaj – Buxheti i vitit 2018 nuk është mbyllur, që të të jap një përqindje, por të garantoj se fondet që kemi marrë, me gjithë rialokimet që kemi bërë, që diku i kemi realizuar dhe diku tjetër jo, për arsye nga më të ndryshmet, do të realizohen 100%, qoftë për investime, qoftë për mallra e shërbime. Për pagat nuk diskutohet që buxheti është i realizueshëm.

Luan Harusha – Pagat janë të detyrueshme, por...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pëllumb Aliaj – Ne kishim planifikuar të blinim një radar stacionar për kufirin, me vlerë 40 milionë lekë. Nuk e realizuam dot, sepse u arrit në konkluzionin që një radar stacionar nuk zgjidhte ndonjë gjë. U bë studimi që të kishim një sistem të integruar për radarët, që të dhënat të vinin në kohë reale në pikën ku kemi QNOD-në. U la që ky projekt të rialokohet në një projekt tjetër dhe të fillojmë ta financojmë në 2019-n.

Buxheti është i realizueshëm 100% për fondet që kemi në dispozicion.

Luan Harusha – Buxheti i këtij viti realizohet 100%.

Po këto materiale, është hera e parë që kërkohen nga ju?

Pëllumb Aliaj – Çfarë materialesh?

Luan Harusha - Baza materiale.

Ermonela Felaj – Kamera, lexues optikë, skanerë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Luan Harusha – Është hera e parë që kërkohet kjo bazë materiale?

Shpëtim Ahmetaj - Mund të përgjigjem?

Ermonela Felaj – Po, mund të bëni një sqarim.

Shpëtim Ahmetaj – Çdo vit, kur hartohet projektbuxheti afatmesëm, identifikohen të gjitha nevojat dhe kërkesat që kanë njësitë shpenzuese. Kjo do të thotë se për vitin 2019 këto janë kërkesa në vazhdim, sepse dylbi nate, dylbi dite, kamera, kemi blerë që në vitin 2013, 2014, 2015 dhe jemi furnizuar, por meqenëse janë pjesë të pakompletuara, vit pas viti hartohen kërkesa. Prandaj themi fishprojekt, domethënë bëhet formulari i identifikimit të projektit dhe ai mund të jetë me shtrirje në kohë. Kështu që nuk kërkohen për herë të parë.

Kur diskutova (po ta keni mbajtur mend), ishte problemi që gjithmonë këto kanë ngelur në kuadrin e kërkesave shtesë mbi limit dhe, po të plotësoheshin kërkesat, absolutisht, mund të them se në vitin pasardhës nuk do të kishim nevojë për to, por ne jemi në pikën që edhe vitin që vjen do t'i bëjmë këto kërkesa, sepse janë mbi limit dhe nuk janë në limite buxhetore.

Në qoftë se ju keni autoritetin t'i miratoni këto kërkesa, absolutisht, vitin tjetër nuk jua kërkojmë më këto objekte.

Luan Harusha – Nga verifikimi në terren (po marrim shembull pikën kufitare Qafë-Botë-Qafë-Thanë) në shtrirjen e kufirit 73 kilometra ishte një kamerë termike, që kishte më shumë se 5 vjet në punë.

Për vitin tjetër janë kërkuar kamera termike?

Ju është realizuar buxheti?

Ermonela Felaj – Ta sqarojmë: ne kemi përpara një material, që sapo na u vu në dispozicion nga përfaqësuesit e Drejtorisë së Kufirit dhe Emigracionit dhe këtu ka fisha të ndryshme për disa projekte, që, nga ajo që ju shpjegoni, më rezultojnë se janë mbi limit, pra nuk janë reflektuar në shifrën aktuale të buxhetit të Ministrisë së Brendshme. Totali i investimeve që kërkohet të financohet arrin në shifrën 191 milionë e 200 mijë lekë.

Besoj se kjo është shifra që na kërkojnë edhe përfaqësuesit, që ne të nxisim Ministrinë e Ekonomisë për të parë mundësinë nëse kjo shifër mund të jepet. Sigurisht, ata do të na thonë një lloj prioriteti, por edhe ne jemi në gjendje ta bëjmë, për faktin e vetëm që kemi qenë në vend dhe, duke e parë në vend, mund të bëjmë një prioritet të këtyre nevojave dhe të vendosim se çfarë mund t'i rekomandojmë ne Komsionit të Ekonomisë, që nëpërmjet tij të mund të realizojmë ndonjë ndryshim.

Luan, nëse më lejon, do të doja të bëja një pyetje dhe ta mbyllja këtu ciklin e pyetjeve.

Që në fillim të prezantimit tuaj folët për çështjen e radarëve. Kam parasysh që kur kemi diskutuar buxhetin 2018 është thënë se na janë dhënë lekë edhe për të investuar te radarët e policisë, ndërkohë situata është e tillë: kemi një qendër të përbashkët, siç është QNOD-ja, që pavarësisht se ka një varësi nga Ministria e Mbrojtjes, po e quajmë, varësi administrative, për shkak të drejtorit të qendrës, është një qendër që përdoret nga disa institucione dhe ka disa radarë, që po i quajmë të ushtrisë dhe disa radarë që janë të policisë.

Në gjykimin tuaj (po e lëmë mënjanë gjykimin që kemi bërë ne), a nuk ka ardhur koha, që në momentin kur flasim për një sistem të integruar të vëzhgimit të hapësirës detare, në rastin

konkret, t'i integrojmë edhe këto forca, pra analizën që bëni ju, me analizën që bën Ministria e Mbrojtjes? Sepse nuk ka kuptim që ne të investojmë veçmas. Nëse do të investojmë do të ishte mirë ta shikonim në tërësi gjithë funksionimin e sistemit të radarëve dhe të siguronim një mbulim të plotë të të gjithë vijës së kufirit blu, edhe pikat e fshehura, që ju i patët merak në fjalën tuaj.

Ky është një problem, të cilin ia kemi vënë në dukje edhe zëvendësministrit të ri të Brendshëm, zotit Lleshaj dhe me gjasë shumë shpejt do të organizojmë një seancë dëgjimore së bashku me dy ministrat, për të marrë një zgjidhje dhe ndoshta për t'i dhënë një formë tjetër QNOD-së, për t'i marrim më shumë produktivitet.

Kjo ishte pyetja ime e parë, por duke insistuar të përgjigjeni, po jua jap fjalën.

Pëllumb Aliaj - Faleminderit!

Që ta sqarojmë përfundimisht, ajo që thatë ju është e drejtë. Ishte ajo arsyeja që nuk e financuam 40-milionëshin. Se po bëhemi si dy palë, por drejtoria e kufirit ka emergjencat dhe nevojat e saj, që e nxisin të kërkojë pajisje për të zgjidhur hallet që i dalin përditë. Ne si drejtori e përgjithshme kemi hallet e të gjithë drejtorisë dhe pastaj bëjmë rakordimet.

Kur erdhi puna për financimin e këtij projekti, duke parë studimin për një radar të veçantë, me grupin e punës arritëm në konkluzionin që nuk duhet të bëhej ky financim dhe ua paraqitëm këtë edhe titullarëve, sepse nuk lidhej dhe nuk integrohej me sistemin e QNOD-së. Nuk zgjidhnim ndonjë gjë me këtë dhe nuk merrnim të dhëna reale në kohë reale, që të merrnim masa, se vërtet e mbulojmë këtë skaf në det, por nuk e kapim dot po nuk erdhën të dhënat në kohën e duhur.

Prandaj u bë edhe studimi i plotë për 405 milionë lekë, që e kemi vënë në fishprojekt. Kjo është bërë në bashkëpunim me QNOD-në dhe Forcat e Armatosura. Kanë qenë specialistët e policisë dhe të QNOD-së, që kanë hartuar termat e referencës. Ka vazhduar 4 muaj ky studim dhe u vendos që nuk do të blihet një radar stacionar dhe arritëm në këtë konkluzion. Ky është qëllimi, që të jetë i integruar. Ne duhet të blejmë stacionet tona dhe t'i vendosim pajisjet, sepse aty ku do të vendosen ato do të ndërtohet kulla e plotë dhe duhet të integrohet me QNOD-në.

Ermonela Felaj – Sa ishte shifra?

Pëllumb Aliaj – 405 milionë lekë të rinj për 6 radarë, që të kontrollojnë zonat pikante të fshehura.

Nëse do të më lejoni, do të sqaroj edhe pjesën e investimeve në total të policisë, që e ngriti edhe zotëria.

Për policinë, limiti i vitit 2019 në fazën e parë dhe të dytë ka qenë 505 milionë. 690 milionë lekë kemi vetëm detyrimin për bashkëfinancim, për blerjen e mjeteve dhe një sistemi tetra, që shërben për teknologjinë e informacionit. Domethënë, limiti ishte gati 200 milionë lekë më pak se na duheshin vetëm për këto dy projekte, por ne kemi kontrata të lidhura me drejtorinë e Shkodrës, me RENEA-n, që nuk mund t'i lëmë pa financuar, sepse sipas ligjit të buxhetit ato kanë prioritet.

Tani, me diskutimet që bëmë me Ministrinë e Financave kemi arritur ta dyfishojmë vlerën limit nga 500 milionë lekë në 1,1 miliard lekë në limit për vitin 2019, duke bërë edhe këto kërkesa, që duhet të na financoheshin patjetër, për kontratat e lidhura dhe bashkëfinancimet, ku kemi shtuar edhe pjesën e kufirit që na duhet për lexuesit optikë, për skanerët, dylbitë e të tjerë. Kështu që për vitin 2019 do të jetë i mbuluar realizmi i financimit të...

Ermonela Felaj - Shumë mirë.

Kam edhe një nevojë të fundit, nuk e di nëse jua kanë sjellë.

Në pikën e kalimit kufitar në Kakavijë, normalisht, nevojitet një strehë ku të mund të qëndrojnë udhëtarët gjatë kontrollit të bagazheve, bëhet fjalë për autobusët me të cilët ata udhetojnë. Ka vetëm një strehë të vogël, që nuk është e mjaftueshme për të përballuar nevojat e qëndrimit gjatë periudhës së dimrit dhe verës. Projekti është modest, me çfarë na u tha në pikën e kalimit kufitar në Kakavijë.

Shpresoj ta keni parasysh dhe ta reflektoni këtë gjë, sepse është pikë e madhe, ku kalojnë mbi 1 milionë e gjysmë udhëtarë çdo vit dhe nuk është e denjë të prezantohemi në këtë mënyrë. Të kemi një ambient sado të vogël, por të jetë i përshtatshëm, që njerëzit edhe në verë kur dielli është i nxehtë apo edhe në dimër kur ka reshje, të mund të qëndrojnë aty brenda kohës kur realizohet kontrolli i gjithë bagazheve të tyre.

Ky ishte një sugjerim për ju, meqenëse jeni edhe personat përgjegjës për detajimin e buxhetit të Ministrisë së Brendshme. Besoj se qëllimi na bashkon.

Fondet akorduar Ministrisë së Brendshme, në fakt, nuk janë pak, sepse kam parasysh që dy vjetët e fundit fondi që ju është dhënë juve dhe Ministrisë së Mbrojtjes është më i larti në raport me çdo institucion tjetër, por ato duhet të përdoren në mënyrë sa më efektive dhe rezultatet të jenë të ndjeshme edhe për njerëzit që punojnë në Policinë e Shtetit, për veten trupën e saj, jo thjesht për ne si parlamentarë apo si qytetarë tek e fundit.

Do ta mbyll këtu këtë mbledhje, duke ju falënderuar për gatishmërinë tuaj për të qenë prezentë!

Sigurisht, nuk mendoj se ky do të jetë takimi ynë i parë dhe i fundit me Drejtorinë e Përgjithshme të Kufirit dhe Migracionit.

Kemi edhe një pjesë tjetër të pikave të kalimit kufitar, që kemi planifikuar ta vizitojmë dhe të kontaktojmë në vend me punonjësit. Kështu që besoj se do ta vijojmë këtë bashkëbisedim.

Punë të mbarë!

Faleminderit!

MBYLLET MBLEDHJA